

Poetja që tronditi gjithë shoqërinë shqiptarë përmes një vëllimi poetik, mbartur vetëm në një fjalë, Rita Filipi duket se i jep përgjigje me vëllimin poetik "Kënga e turmës", të shoqëruar me skica, dhe imazhe erotike por jo më, me këngë të tilla; raporti mes intimes, erosit dhe një personaliteti krijues të poetes me pretendimin utopik për ndryshimin e shoqërisë...

RITA PETRO

KUR FILLON TË NDIESH GJUHËN E TRUPIT PËRMBYSEN TË GJITHA MITET, DIKTATURAT



Portreti nga Ina Lajthia

OPINION

SHQIPËRI-KOSOVË, KALENDARËT E PAMJAFTUESHËM KULTURORE...

Nga Violeta Murati

(fq. 5)



TEMPUJT LETRARË TË KADARESË

Nga Zuvdi Hoxhiq

80-VJETORI I LINDJES



VAÇE ZELA IKU ME NJË PENG: "TË KISHA KËNDUAR MË SHUMË KËNGË DASHURIE."

Nga Aleksandër Peçi

(Fq. 9)

Te Vilsoni dhe Genci në Bërzeshtë

Nga Yzedin Hima

(Fq. 5)

Ilire Vinca, jeta në skenë

Intervistoi Anila Dedaj

(Fq. 12)

Romani i Stefan Çapalikut
botohet në italisht

(Fq. 9)

"Valsi i lumturisë" i Ylljet
Aliçkajt në frëngjisht

(Fq. 11)

PROFILI PREJ SHQIPËRUESI I ATË BENEDIKT DEMËS

Nga Evalda Paci

(fq. 10)



(Fq. 14)

KRAHASIME TË PËRKTHIMEVE TË K. KAVAFIT NË GJUHËN SHQIPE

Nga Aristotel Spiro



**PIERFRANCO
BRUNI**

**ATI IM ISHTE
NË DALMACI**

BIBLIOTEKË

Poetja që tronditi gjithë shoqërinë shqiptarë përmes një vëllimi poetik, mbartur vetëm në një fjalë, Rita Filipi duket se i jep përgjigje me vëllimin poetik “Kënga e turmës”, të shoqëruar me skica, dhe imazhe erotike por jo më, me këngë të tilla; raporti mes intimes, erosit dhe një personaliteti krijues të poetes me pretendimin utopik për ndryshimin e shoqërisë...

RITA FILIPI KUR FILLON TË NDIESH GJUHËN E TRUPIT PËRMBYSEN TË GJITHA MITET, DIKTATURAT

Intervistoi: Violeta Murati

A mund të na kujtoni kur keni dëgjuar zërin tuaj, të brendshëm për të shkruar? A keni një kujtesë?

Kur duhet të shkruaja për partinë dhe xhaxhin Enver. Për të qeshur apo jo?! Por më fal, që të vegjë, vetëm vargje për ta na nxitnin të recitonim përmendsh dhe të shkruanim. Madje vihej në dyshim dhe dashuria për prindërit, nëse ishte ajo e para apo e dyta. Pastaj erdhi adoleshenca dhe gjithçka u kthye përmby. Kur fillon të ndiesh gjuhën e trupit përmbysen të gjitha mitet, të gjitha institucionet, të gjitha diktaturat. Atëherë fillon të mendosh se ke ardhur në këtë jetë nga një fuqi më misterioze se ajo që mundohen të të injektojnë në tru; fuqia e erosit si filozofi jetësore. Dalëngadalë ky ishte zëri më i fuqishëm që filloi të diktojë te unë imazhe e ndjesi që vazhdoj t'i shenjoj dhe sot nëpërmjet fjalëve.

Kur keni botuar për herë të parë? Si kanë ardhur librat tuaj më pas?

Të revista “Nëntori”, pastaj gazeta “Drita”, por sigurisht jo poezi sirtari. Poezitë e sirtarit i përmbledha në vëllimin “Vargje të përfolura” botuar në 1993. Ishte një libër që ra menjëherë në sy dhe të gjitha kopjet u shitën shumë shpejt dhe për shkak të një interviste jashtë çdo skematizmi që organizoi asokohe në TVSH gazetari i mirënjohur Alfred Kanini. Pastaj disa nga poezitë e mia u bënë tekste këngësh si “Nëse natën vij...”, “Pesë fustanet dhe adhuresit” etj. Libri tjetër “Shija e instinktit”, 1998 u përrua në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe u gëzova fort se studiues e shkrimtarë të njohur patën shumë vlerësime pozitive, duke e quajtur poezinë time si një poezi që nuk ia përcakton dot as kohën, as vendin, as brezin për shkak të një mesazhi universal... e kështu me radhë

u botuan “Këtu poshtë këndohet live”, ku u përfshi dhe cikli për figurën e Krishtit, poema me të njëjtën titull, etj. Derisa një ditë të bukur erdhi vullkani “Vrima”, pra, jo rastësisht dhe aq më pak qëllimisht.

Ju i takoni një brezi që besojmë ka gjurmë nga diktatura, si ishte adoleshenca juaj? Ndikimi që pati tek ju dhe si e shihni nga këndvështrimi i sotëm?

Po, i përkas atij brezi që provova edhe sistemin arsimor në atë kohë dhe atë të punësimit. Ndonëse kam jetuar në një familje me “biografi të mirë” e kam ndjerë gjithnjë te prindërit presionin që vinte nga lart, frikën se në çdo moment ishe i përgjuar, atë çka ndodhte me miqtë e tu që i përkisnin familjeve me “biografi të keqe” etj., etj. Por kur je i ri në çdo kohë dhe në çdo sistem, i gjen më kollaj mënyrat e tua të argëtimit, qofshin këto dhe të

ndaluara. Ja psh., Nuk do ta harroj kurrë kur donim të bënim “jetë nate”, mblidheshim në shtëpitë e njërit-tjetrit, mbyllnim dritaret me batanije dhe dëgjonim muzikë Rock apo kur ndryshonim vargjet e këngëve të Beatles-ave dhe i bënim shqip, për t'i kënduar me zë të lartë në zборе dhe aksione. Kulmi arrihej në plazh që kur shihnim nga larg një polic, të gjithë ndryshonim stacionin e radios menjëherë. Nuk i kam shpëtuar dot, megjithëse s'kam qenë kurrë ekstravagante, fletërrufeve për shfaqje të huaja... apo në punë kur punoja te Shtëpia Botuese e Libri Shkollor jam sulmuar se po prishja ato skematizmat që ata i kishin ngulitur, e s'kish burrë nënë që t'ua lëvizte. Megjithatë... megjithatë në këto 57 vjet të jetës sime kam kuptuar se në thelb njeriu mbetet njëlloj pavarësisht sistemeve. Më vjen keq kur njerëz të caktuar me poste shtetërore sot janë aq të ngjashëm në sjellje e foddullëk, në moszbatim të ligjit (pasi mendojnë se ligji janë ata vetë) njëlloj si ata të kohës së diktaturës; të vjen keq se prapaskenat e të paafëve ndaj të aftëve janë të njëjta të frikshme me ato të asaj kohe. E vetmja gjë që ndryshon është, se nuk të presin kokën, por të shkaktojnë dëme morale, profesionale e materiale.

A ka një angazhim konkret te ju, kuptojmë me krijimtari, për ta përballur shoqërinë, jetën sociale këtu?


Të them të drejtën i vetmi angazhim imi është të mbijetoj bukur në raport me kurthet që na ngrihen prej hipokritëve dhe të paafëve. Dalja në sipërfaqe të gëzon shumë e njëherësh është rrezik; nuk të duron kush të kesh dhe pushtet intelektual dhe pushtet mirëqenieje. Mundohen të të hanë mishin e të të lenë skeletin (si peshkut të Heminguejit). Por preferoj luftën këtu e të mbetem me një skelet aq të bukur të një fitoreje të madhe, se sa të iki apo të tërhiqem nga fusha e mejdanit. Ajo do të ishte vdekje për mua dhe më ka pëlqyer aq shumë kur një gazetar i mirënjohur më ka quajtur amazonë (ndonëse qëllimi im më i madh nuk është lufta, por dashuria).

Raporti mes intimes, erosit e në mundsh, të ruash edhe personalitetin... si ndërveprojnë tek ju?

Duket pak si vështirë, pasi profesioni im (që e ushtroj prej 35 vjetësh) në edukimin shkollor, por edhe tani si botuese shkojnë kundër kësaj në pamje të parë. Njerëzit kanë konvencione në mënyrën se si e trajtojnë njeriun serioz nga ai jo serioz; gruan serioze nga gruaja jo serioze. Pak për të qeshur, por me mua ndodh shpesh kjo, Kur më shohin të ftuar në emisione televizive apo në takime, seminare, trajnime etj., shtangen pasi iu dukem shumë serioze. Kanë krijuar në kokën e tyre një imazh tjetër duke nisur nga vargjet e mia me një gjuhë krejtësisht të çliruar. Jeta ime e përditshme, mënyra e sjelljes sime nuk ka lidhje me artin; arti krijohet nga nënvetëdija e artistit, në jetën e përditshme është arsyeja që udhëheq mbijetesën tonë që iu përshtatet rregullave të shoqërisë ku jetojmë. Por përsëri këmbëngul se parimi mbi të cilin përpigëm të bëj jetën time si individ apo si krijuese është vetëm një: sinqeriteti dhe guximi për të fituar sa më shumë liri në terrenet e kufizuara prej censurës dhe autocensurës.

Ju shkruani për jetën tuaj?

Çdo ditë e jetës sonë duket sikur ikën, shuhet, po kështu dhe vitet, por në fakt ato janë shtresëzuar aty në trurin tonë. Të gjitha shkruhen aty me një majë të mprehtë, si një sizmograf që regjistron luhatjet e ndjesive dhe të mendimeve tona. Mjafton të kesh durimin t'i deshifrosh, t'u nxjerrësh kuptimin. Dhe në këtë rast gjithkush e ndien se ti si shkrimtar je frymëzuar dhe udhëhequr nga imazhet e tua personale për të shkruar historinë e tjetrit që është lexuesi. Po ndodh dhe e kundërta; ka shkrimtarë që shkruajnë historinë e dikujt tjetri, duke iu fshehur vetes. Ata s'mund të jenë të dashur për lexuesin, pasi lexuesi s'mund ta gjejë veten te historia e tjetrit. Një lexues e gjen veten vetëm te historia e sinqertë e shkrimtarit. Arti vërtet është trill, sajim i shkrimtarit apo poetit, por nuk duhet të bjerë në nivelin e sajësës; e figurave





dhe imazheve të kërkuara për ta bërë shkrimtarin të duket bukur boll i mençur.

Ç'është për ju poezia? Gjithnjë keni dashur të jeni poete? Përse jeni poete?

Nuk mund të them atë që do të thoshin shumë krijues, që jeta ime pa poezinë nuk do të kishte kuptim. Jeta ime do të kishte kuptim edhe pa shkruar. Ndërsa jeta njerëzore nuk do të kishte kuptim pa artin në përgjithësi dhe pa artin e poezisë në veçanti. Jeta njerëzore do ishte bardhezi pa ngjyrat që i jep arti. Ç'është poezia? Poezia është një imazh i kulluar që na vjen në mendje nëpërmjet emocioneve që marrim dhe këto nuk janë vetëm emocione të çastit. Ato fiksohen ditë pas dite, vit pas viti në kujtesën tonë dhe vjen një çast kur ndodh metamorfoza...imazhet kthehen në fjalë. Kjo është poezia, që në ndryshim nga proza ka një nëntekst shumë më të fuqishëm, se përmbledhet në aq pak fjalë.

Përse jam poete? Më është dhënë kjo dhunti, të cilën unë nuk e shndërrova në profesion. Nëse ka një art i cili zor të shndërrohet në profesion, mendoj se është poezia. Mund ta kem dhe gabim, por unë kështu e mendoj. Njerëzit kanë një standard në kokë për sa i takon poezisë. Kur të takojnë ose kur janë me ty dhe ndërkohë po perëndon dielli pas shpinës tënde, ata të thonë në mënyrën urdhërore: "Bëj një poezi tani! Po kështu kur shohin që ndodh një padrejtësi, të thonë: Bëj një poezi kundër të keqes! Sigurisht çdo poet, të paktën mbi mesataren, mund të shkruajë për këto dukuri që ndodhin çdo ditë. Po kësaj i thonë të vargëzosh duke kërkuar krahasime dhe epitete. Poezia është metaforë e jetës, është një sintezë imazhesh e ndjesish që arrijnë majat më të larta te poeti, pasi ajo është mbarsur në trurin e tij, siç mbarset gruaja apo toka me farën e re.

Keni "dhënë" jetën tuaj si shkrimtare e poezisë erotike, në një botë që ende mbizotërojnë burrat...

E bukur kjo shprehje. Në një fragment poetik nga libri "Vrima" kam shkruar "Oh i dashur/ truri im është ky/ në duart e mia larë në gjak/ a mund të mendosh me trurin jashtë?"

Po këto vargje vërtet janë tronditëse? Çfarë përjetuat ato momente?

Hapja maximale (10 cm e gruas në momentin e lindjes) ndaj dashurisë, ndaj krijimit është aq e thekshme dhe njëkohësisht aq magjike, por që bota e burrave është privuar për ta ndjerë në këtë mënyrë, ndaj gjithnjë kam menduar se ne gratë kemi një privilegj më të madh, se sa burrat në raport me erosin: atë ndjesinë e gjithçkasë që ndodh në brendësi të trupit tonë në raport me burrat që fara iu derdhet jashtë trupit të tyre. Ndaj figurativisht do të thosha se libri "Vrima" është

shkruar nga dhimbjet e lindjes së trurit dhe duke e mbajtur atë në duart e mia.

Ju kapni në poezitë tuaja një temë të gjerë të identitetit dhe të përvojës femërore. Pse drejt kësaj ideje?

Shiko, dëgjoj shpesh që poeti i mirë nuk ka gjini, nuk i dallohet gjinia. Nuk jam kundër kësaj pasi një mesazh universal nuk është as femëror dhe as mashkullor. Dhe shumica e poezive të mia janë të tilla. Por unë nuk vuaj as nga kompleksi, që kanë disa poete se mos ngjaj si femër. Unë jam femër dhe truri im do apo nuk do komandon një trup me organe gjenitale femërore. Instinktet e mia më tepër do ngjasojnë me instinktet e një ulkonje apo luaneshe, se sa të një ujku apo të një luani. Nga ana tjetër, ka dhe letërsi të ashtuquajtur femërore, kur tematika është e një natyre të kufizuar dhe i drejtohet në një mënyrë komerciale apo të angazhuar vetëm botës femërore. Në këtë rast, kemi të bëjmë me një letërsi brenda kornizave. Në poezinë time është individ i përgjithshëm (dhe indirekt femra, gruaja) që përballlet me dukuritë e jetës gjatë udhëtimit nga lindja në vdekje. Shumica e këtyre ndjesive dhe eksperiencave janë të njëjta si për botën femërore ashtu dhe për atë mashkullore. Ndaj poezia ime nuk ka tematikë femërore, gruan, problemet e saj; femra gruaja janë boshti rreth të cilit sillet kozmosi.

E cilësuar poete e erotit, që me vëllimin poetik "Vrima" thyen tabu, që trondit 'normat' e një shoqërie përballë seksit. Të ka emocionuar kjo, si i keni pritur reagimet apo keni provuar ndjesi të kundërt nga ajo që merr një poet, kënaqësinë, çfarë...?

Fillimisht jam gjendur e papërgatitur. Nuk kam qenë asnjëherë në qendër të vëmendjes të aq shumë njerëzve...*Vrima* u kthye në epidemi, një çudi që nuk zgjati 3 ditë, por më shumë se një javë dhe vazhdon edhe sot. Në atë kohë nuk kishte statuse në fb pa u përmendur *Vrima*, nuk kishte bisedë të njerëzve pa u tallur me *Vrimën*. Dukej sikur shoqëria mezi kish prituri fjalën *Vrima* për të nxjerrë në një tepsi të përbashkët gjithë ushqimin e keq që kish ngrënë për shumë e shumë vite. Dhe në këtë pikë unë dhe shumë njerëz të tjerë që

mendojnë si unë themi, më mirë që ndodhi kështu. Kjo gjë sot më është kthyer në adrealinë dhe e di shumë mirë që në biografinë e një poeti është një plus shumë i madh kjo ngjarje. Të provokosh një shoqëri të tërë vetëm me një fjalë, nuk është gjë e vogël; të shkruash vargje që tronditin, është gjë e madhe. Dhe për mua, që gjithçka e bëra spontanisht, mendoj se kjo kthehet një ditë në vlerë, sepse sikur poezitë e mia mos kishin vlerë, ato nuk do të ishin tronditëse.

Në fakt unë e kisha ndier një lloj shtangijeje te njerëzit e mi që e lexuan për herë të parë "Vrimën", ende pa u botuar. Kur ua lexoja disa fragmente poeme, e shihja se si mbeteshin dhe reagonin me vonesë. Aty fillova ta kuptoj se kisha shkruar një libër të mirë. Por kurrë nuk e kam parashikuar një vullkan të tillë, mbase instinktivisht po, sepse libri "Vrima" u shkrua pas 15 vjetësh që u botua "Kënga live" dhe te unë ishin mbledhur si një llavë vullkani ndjesi të pafundme, të cilat kishin nevojë të shpërthenin. Në të gjitha kontekstet *Vrima* është vullkani, i cili shkatërron dhe njëkohësisht, mbi të riciklohet një jetë e re.


Cili është imazhi më erotik që mund të sillni në mend ose që ju ka kthyer ankthet, dhe misterin në një muzë?

E kam shprehur në poezinë "Dashnori Krisht"; është një imazh fantastik ajo koka e anuar anash, ku në qafë duken shenjat e dhëmbëve të ngulura. "Dhuna" pa kaluar në sadizëm apo mazohizëm është mënyrë e bukur për të arritur kulmin e kënaqësisë trupore dhe atë trunore, do të shtoja. Ekstaza arrihet kur trupi lihet në një gjendje lirie absolute...Dhe kënaqësia që përftohet prej kësaj është një dhimbje e bukur e thekshme. Ky është akti i vetëflijimit për hir të dashurisë...prandaj gjithnjë e kam parë imazhin e vuajtur të Krishtit të gozhduar me kokën dhe qafën e anuar si një vetëflijim madhështor për hir të dashurisë njerëzore.

Jeni prezantuar me një tjetër vëllim "Kënga e turmës", pse e tillë? A mund ta marrim si një përgjigje?

E quajta "Këngët e turmës" e shtyrë nga lexuesit. Para epidemisë *Vrima* unë, si shumë poetë të tjerë, kisha një rreth shumë të vogël lexuesish, si dhe isha e njohur në qarqet letrare. Pas skandalit *Vrima* mua m'u zgjerua me përdhunë rrethi i lexuesve. Ajo që më bëri përshtypje ishte se pas leximit të librit nuk pati asnjë reagim të ri kundër vargjeve të mia provokuese. Përkundrazi, ata lexues që lexuan vetëm *Vrimën* filluan të kërkojnë poezitë e mia të mëparshme. E dija se librat e mëparshëm patën jehonë vetëm në qarqet letrare, por jo te lexuesit në masë të gjerë. Kështu që vendosa të botoj poezitë e mia të shkruara ndër vite, si dhe poezi të reja.

(Vijon në faqen 4)



(Vijon nga faqja 3)

Meqë është një botim koleksioni, me imazhe, piktura dhe poezi të mbledhura, cili ka qenë procesi?

Poezitë janë renditur sipas botimeve të mëparshme duke filluar nga “Vargje të përfolura” 1993, “Shija e instinktit” 1998, Këtu poshtë këndohet live”, 2002, cikli “Në mes dy botëve” 2016 dhe gjithashtu janë përfshirë poezi e poema të reja te cikli “Mëkati i shegës”. Dikur unë dhe vizatoja imazhet që më vinin në kokë dhe para se t’i bëja poezi i pikturoja. Pra ato nuk janë thjesht ilustrime të poezive, por qëndrojnë dhe më vete. Mendoj t’i rikthehem përsëri vizatimit dhe pikturës me bojë vaji. Kam shumë imazhe në kokë, të cilat do të më ndihmojnë në aventurën time prej amatoreje. Format i katror i librit është i njëjtë me librin *Vrima*, pra ndihmon në puthitje. Është bukur kur ti ke dy ose më shumë libra të një shkrimtari dhe ato të puqen bukur në bibliotekë...dhe kur do t’i rikthehesh, i gjen kollaj.

Vargjet: Këndova këngën tënde turmë,/Më shumë se këngën time,/ Se gërmova aty thellë ku ti ke frikë të hysh,/ nga manipulatorët...sigurisht kjo është një ide e shkëputur nga konteksti, por për ju pse një vendim i tillë, për “Kënga e turmës”, ç’raport krijon me vëllimin “Vrima”, konsideruar në kufijtë e skandalozes?

Turma në vetvete është shumë e bukur dhe ndjellëse; turma është gojëpisët, e shthurur, mbushur me të marrë dhe të mençur, ndaj është shumë potente. Kur turma manipulohet është e rrezikshme se i kthen gjërat mbrapa duke shkatërruar; kur turmën e drejtojnë liderë të vërtetë, ajo shndërrohet në popull. Askush nga ne nuk është i imunizuar nga të rënjtë në rrjetën e psikologjisë së turmës. Sa herë e kemi kapur veten në këtë rrjetë. Disa mbesin aty gjithë jetën, disa luftojnë të dalin e të krijojnë individualitetin e tyre. Por turma ka dhe diçka të mrekullueshme. Të eksiton. Sa e bukur bëhet turma kur këndohet kënga e saj e shpirtit. Atëherë trupat bashkohen e ngjiten njëri pas tjetrit...jo për seks, as për lavdi...është dëshira e trupit, Muzika. Kjo është kënga e turmës për të cilën kam kënduar unë, pra për ata dhe për vete...në instinkte jemi pothuaj njëllor, na ndajnë vetëm kufijtë e formalitetit.

Çfarë është kultura për konceptin tuaj? A mendoni se prej saj varet natyra e poezisë që shkruani?

Sigurisht që varet shumë. Unë do përsëritja thënien e grekëve të vjetër se: U di atë që s’di asgjë. Sa më i ditur të jetë një njeri, aq më shumë dije i dalin si sfidë. Ndaj njeriu për të bërë një jetë të bukur e pa stres, duhet t’i seleksionojë dijet. Dijet nuk janë për t’u mburrur. Ka disa njerëz që vetëm numërojnë emra pa fund dhe vepra apo citime njerëzish të mëdhenj. Për mua, i ditur është ai njeri, që kulturën e vet e vë në shërbim të së përditshmes së tij, në shërbim të profesionit, të komunikimit me të tjerët dhe të ndjesive të tij. Për shembull, ne të gjithë dashurojmë, madje edhe njeriu që s’di shkrim e këndim. Por sa bukur është të dashurosh si një njeri i ditur. Në këtë kuptim, unë nuk kam krijuar mite në kokën time; pëlqej pothuaj gjithë veprat e mëdha shkruar në stile të ndryshme e në kohë të ndryshme dhe ato më kanë formuar mirë besoj.

Poezia juaj është një udhëtim i brendshëm, ndjesi dhe imazhe jo të zakonata - a mund të na thoni keni ndonjë vend favorit që lexoni apo shkruani? Çfarë ka ndikuar?

Sa pyetje e bukur, por që përgjigjja ime është krejtësisht e kundërt me të. Jo unë nuk kam asnjë vend ku shkruaj; asnjë poezi nuk është shkruar fillimisht në letër; të gjitha janë mbaruar në trurin tim. Prandaj mund të shkruaj kudo ku ndodhem, në restorant, në zyrë, në shtrat, gjatë një konference, në një shfaqje, në një bisedë miqsh, duke ngarë makinën, në banjë etj, ej. Psh; shumica e fragmenteve të poemës *Vrima* janë shkruar duke notuar. Mua më pëlqen shumë maratona e notit “stil i lirë”. Më jep një hapësirë të



mrekullueshme mendimi kur ndiej ujin që më futet e gurgullon në çdo vrimë e pore të trupit tim, më pëlqen dhe gurgullima apo zhurma kur krahët dhe këmbët futen e dalin mbi ujë. Dhe kam një shprehje të bukur krejtësisht autentike: “Free stile është njëllor si në jetë; të dish të mbash ritmin, të kesh nën kontroll frymëmarrjen, t’ia dorëzosh trupin kënaqësisë”. Ky është dhe parimi im kur shkruaj poezi...të kem nën kontroll gjithçka, por dhe t’i dorëzohem frymëzimit poetik.

Kur një poezi sipas jush i përket intimes, erosit asaj zone të errët që pak guxojnë të jenë të hapur, ku janë skajet estetike dhe asaj thjesht si guidë erotike?

Veç një fill e ndan erotikën nga pornografikja, po kështu dhe në art. Nuk ka shumë fjalë për ta shpjeguar këtë. Është diçka që ndihet. Edhe kur bën seks, e kupton nëse partneri ka ndjenja për ty apo thjesht epsh. Edhe kur lexon një libër e kupton, nëse shkrimtari do të të ngacmojë ty seksualisht apo do të zgjerojë kufijtë estetike të imazheve të tua erotike. Kjo e dyta është e mrekullueshme.

Në ç’mënyrë i shërbeni librit tuaj për t’u njohur, përhapur?

Mendoj se tani ka disa mënyra shumë të bukura për të shkruar poezi të lexuesi. Është e habitshme, por më ka ndodhur kur më kanë ftuar të lexoj poezi, në disa lokale nate ku ka muzikë live e kryesisht Rock. Është aq bukur të kombinohet poezia me Rock-un apo baletin. Të gjithë e mbajnë mend “Penetrimin e shpirtave” me regji të Arian Sukniqit dhe debutimin e balerinëve të mrekullueshëm, skenari i të cilit u ndërtua mbi librin “Vrima”. Salla ishte plot dhe nuk pipëtinte askush kur recitoheshin vargjet. Kam përjetuar një ndjesi të mrekullueshme. Dhe prapë me Sukniqin kemi një ide të çmendur në kokë.

Çfarë është një ditë tipike e të shkruarit për ju?

Profesioni im i të shkruarit nuk është poezia siç e thashë më lart, por të shkruarit e teksteve shkollorë të letërsisë. (pa u mburrur mund të them se numri i teksteve, ku unë jam si bashkautore ka shkruar 40). Këtë punë e bëj me aq pasion, si dhe kur shkruaj poezi. Poezia më ushqen përditë me shumë dashuri dhe më ka zgjeruar rrethin e njerëzve që më duan dhe i dua.

A vazhdoni të jeni ende me mendimin se natyra femërore, ju, e keni sfiduar vërtet botën dhe

ndryshuar atë? E keni pasur një utopi në këto poezi, që i përkasin ’98-ës.

Disa nga poezitë e mia të librit të parë dhe të dytë i përkasin viteve të diktaturës, pra janë shkruar si një rebelim që kish ngritur krye brenda kufijve të trupit apo të trurit tim. Këtë mund ta vërtetojnë shumë miq të mi të cilëve ua jepja të m’i lexonin në ato kohë. Dhe ata me shaka më thonin që t’i mbaja të fshehura se do kisha probleme. Ndërsa unë i mbaja në sirtar se as më shkonte mendja se do t’i botoja apo se isha e denjë për t’u quajtur poete. Duke qenë poezi kaq të virgjëra ato janë shumë të denja për të analizuar botën femërore para dhe pas viteve ’90. E thashë dhe më lart, jo vetëm si femër por dhe si individ i kam përjetuar dy periudhat para dhe post diktatoriale. Dhe kam zgjedhur t’i këndoj më tepër autocensurës se sa censurës. Se lufta më e madhe është ajo që bëjmë me veten tonë dhe rrethin e ngushtë të njerëzve që jetojnë me ne. Unë kam një poezi në dukje naive: Unë do ta ndryshoj botën / hipur mbi biçikletën time të kaltër / që ecën me energjinë e muskujve të mi...Gjthkush nga ne kur është i ri ëndërron për princ të kaltër dhe një botë me re të kaltra; është bukur të ëndërrosh ëndrra të kaltra, por më bukur të fillosh të sfidosh në jetë retë e zeza dhe vetëtimat. Bota është aq e madhe sa nuk e ndryshon dot një njeri, këtë fillon të kuptosh kur përballesh me jetën, siç kupton kur fiton në disa sfida, se secili prej nesh mund të ndryshojë botën e vogël rreth e qark tij. Në këto sfida, të qenit femër më ka ndihmuar. Mendoj se meshkujt janë më të dobët se femrat, sepse kanë më shumë komplekse se femrat, komplekse të ushqyera nga gjyshet dhe mamatë e tyre. Dhe një femër e mençur nëse di ta kuptojë këtë nuk ka pse ta quajë veten seks i dobët, përkundrazi mund të bëhet lidere me armët e veta të feminilitetit, të elegancës, dhembshurisë dhe të fortësisë së mbijetesës, pse jo edhe të atyre negative, që siç them unë në një nga poezitë: Do të të sfidoj me pabesinë e seksit femëror! Nëse meshkujt zgjedhin armë të dobëta për të na sfiduar dhe ne s’mund të zgjedhim armë të tjera. Ka rregulla në dyluftime. E gjithë jeta jonë është e bukur se në bazë të saj është lufta mes seksit mashkullor e femëror. E gjithë jeta jonë është e bukur nga dashuria mes SEKSIT mashkullor dhe femëror.

TE VILSONI DHE GENCI NË BËRZESHTË

Nga Yzedin Hima

Lumi Shkumbin rrëshqet si lot në këmbët e Bërzeshtës. Në përgjithësi, lumi është i shenjtë për poetët. Poeti kërkon përherë rrjedhën, kaltërsinë, freskinë dhe sidomos, synon hapësirën, sikurse lumi detin, drejt të cilit shpejton. Poetët i grish pamja e shpinës së lumit që merr me vete peizazhet, teksa vrapon drejt detit, sikurse imazhet e bukura të shpirti të poetit.

Nëse mund të formonim një antologji poetike për lumin, besoj se do të kishim një mrekulli poetike, ku rridhnin lumenjtë e botës, të cilët pihen plot etje nga dete e oqeane. Poeti shkon shpesh te lumi, edhe kur ai është ujëpakët edhe kur është ujëshumë. Dikush shkroi se donte që lumin e pranverës ta merrte dhe ta “fshihte ndër dejet e tij”, për shkak se nuk e shikonte dot në verë tek zvarritej i holluar, i hutuar apo edhe më keq, i tharë. Ndërsa një tjetër shkruan se kur hodhi grepin në lumë, në vend të peshkut, “kapi” veten e tij.

Ndërsa kalova lumin Shkumbin, m'u kujtua akuza e ngritur nga diktatura për Vilson Blloshmin dhe Genc Lekën, dy poetët e Bërzeshtës, dy poetët e Shqipërisë, dy poetët e Botës. Krahaz akuzave të fabrikuara kundër tyre, ata që nuk kanë ditur kurrë se çfarë është poezia dhe çfarë është poeti, ata që janë të dënuar përjetësisht të mos e mësojnë këtë në jetë të jetëve, vunë kundër tyre, më të dashurin, më të dëlirin, atë që rridhte së pari brenda qenies së tyre... lumin.

“Të pandehurit Vilson Blloshmi dhe Genc Leka! Keni sabotuar. Keni derdhur plehun kimik, superfosfatin, në lumin Shkumbin, për të dëmtuar kooperativën”.

Lumi përballë Vilsonit dhe Gencit?! Si dëshmitar kundër tyre. Barbarët nuk e kishin problem për të sajuar lloj-lloj dëshmitarësh, por deri te lumi?! Ç'mendje diabolike! Vilsoni dhe Genci do të pranenin të dëshmonte kundër tyre këdo, edhe njerëz të afërm, por lumin jo. Nuk ka fyerje më të madhe për poetin dhe lumin. Natyrisht, poetët nuk iu zemëruan lumit. Në vend të tij foli dikush që pretendonte se qe fshehur te një ferrë pranë lumit...

*Diku mbeta, diku mbete,
Ndofta s'gemë as ti, as unë...!
Shkel e shkon mbi cifta jete,
Ikën koha rrjedh si lumë...*

Shkruan Vilson Blloshmi në një poezi të tij.

Duke u ngjitur, i pari “banor” i Bërzeshtës që “të përshëndet” me krahët në erë, është Rrapi i Bërzeshtës, shekullor, me përmasa të pazakonta. Ai brof nga toka për të përqaftuar qiellin, ndonëse nga larg duket sikur varet nga qielli drejt tokës. Ç'monument i hatashëm natyre! Çfarë komunikimi tokë-qiell! Më kujtohen krahët e brishtë të Vilsonit, krahu i tij i thyer nga hetuesit barbarë, të cilin e ngrinte me dorën ende të pathyer për ta vendosur mbi gju në atë gjyq, shkruar me aq dhimbje nga poeti Sadik Bejko në monografinë e tij për dy poetët. I vetmi mëkat i krahut të thyer qe se kishte shkruar poezi të mrekullueshme, se kishte përkthyer poetët simbolistë frëngë, se priste Ahe në Stravaj, se korrtë “arat e mbjella me lesh, apo qethte iriqin në arat e varfra të Bërzeshtës”.

“Ky rrap është monumenti i poetëve”, - mendova. - “E ka bërë Zoti për ta, në kujtim të shpirttrave të lartë, vrrarë nga të pashpirtët”.

Duke u ngjitur për te shtëpia e Blloshmëve, ndesh një buronjë. Sa njerëz kanë shuar etjen aty, midis tyre edhe djemtë e Bërzishtës, Vilsoni me Gencin! Aty, të përkulur pinin ujë e qiell, por etjen nuk e shuan kurrë... Vetëm një poet i etur, tejet i etur për ujë, gjelbërim, poezi, liri, jetë, drejtësi, dashuri, mund të shkruante një tekst poetik si “Saharaja”:

*As edhe një s'e di si është katandisur,
Me këtë plagë mbi shpinë rruzullimi,
Por se thonë në botë është stisur,
Kur i dubej njerëzisë mallkimi.*

Shtëpia e Blloshmëve gjendet në ballë të Bërzeshtës, me dy kate dhe plot dritare si sy, që shohin nga dielli. Shkrimtari Virion Graçi flet i habitur se si kjo shtëpi e braktisur prej dekadash qëndron në këmbë, sikur banori i fundit të qe larguar dje. Bedri Blloshmi pret pelegrinët e ardhur nga larg për të nderuar në ditëlindjen e tyre, më 29 mars, Vilsonin dhe Gencin. Lindën në një ditë, por në vite të ndryshme, dhe ikën nga kjo botë në të njëjtën ditë, të përshkuar nga plumbat e urrejtjes në përroin e Firarit.

Lumi Shkumbin atë ditë, “i përgjakur” dhe i fyer, vrapoi drejt detit, ndërsa miqtë e tij, poetët e Bërzeshtës, poetët e Shqipërisë, poetët e Botës, u ngjitën drejt qiellit.

Ecim në rrugët e ngushta të Bërzeshtës, ku dikur linin gjurmët e tyre Vilsoni me Gencin. Gjurmët e tyre janë zbehur, tretur në tokën e ashpër të Bërzeshtës, ndërsa atje lart, qielli i ruan si meteorë.

*Ndërsa vërsulet globi në honin e pamatë
Me njërën faqe ditë dhe me faqen tjetër natë.
Dhe zgjuar shpesh bashkoj unë mbrëmjen me mëngjese...
Eh botë faqe-bardhë! Eh botë faqe-zezë!...*

Shkruan poeti Vilson Blloshmi.

Vendi që vret poetët, pra shpirtin e kombit, është vend faqezi, në jetë të jetëve do ta vuajë këtë mëkat.



Shtëpia e poetit Vilson Blloshmi, Bërzeshtë

OPINION

Shqipëri-Kosovë, kalendarët e pamjaftueshëm kulturorë...

Është viti i gjashtë që ministratë e kulturës mes Shqipërisë e Kosovës nënshkruajnë një kalendar të përbashkët kulturor. Me këtë, politika e dy vendeve ka parasysh ngjarjet e artit në të dyja shtetet: teatri shqip i Kosovës në teatrin shqip të Shqipërisë; piktorë të GKA-së në Shqipëri të këmbëjnë, aq sa kanë, me punët e GKA-së në Kosovë; po kështu edhe qendrat kinematografike apo arkivi i filmit etj., duke mos harruar në fund edhe aktivitetet që mund të bëhen për librin dhe trashëgiminë. Deri këtu duket se preken të gjitha fushat e kulturës dhe artit, dhe zyrtarisht korrekt-letrat veç bashkojnë dy ministrat në një tryezë me disa kamera para. Por, çfarë ndodh realisht pas kësaj agjende politike mes dy vendeve? A është mjaftueshëm që dy ministra të bëjnë “exchange” projektesh, vetëm projekte, pasi kultura është një, gjuha është një. A është i mjaftueshëm komunikimi ynë kulturor, në një? Ndërsa arsyeja pse krijuesit bëjnë veprat e tyre është një, pra gjuha e kultura shqip, duket se kjo arsye nuk ka përputhje reale, konkrete. Jo pak herë, prej tri dekadash shkrimtarë e njerëz të kulturës e kanë të vështirë të identifikojnë punën e tyre si mbarëshqiptare, sepse komunikimi vazhdon të mbetet i izoluar. Përpjekjet e deritanishme për t'u njohur, siç është dëshmuar, kanë qenë më tepër individuale. Kur shkrimtarit e publicistit Kim Mehmeti iu akordua vjet në nëntor, në panairin e librit në Tiranë, çmimi i madh i botuesve, ai qe shprehur se pikërisht tani kur asgjë nuk e ndalon qarkullimin kulturor mes vendeve, ka nisur “të na pëlqejë jetesa e ndarë nëpër principatat tona politike, letrare e kulturore. Kemi filluar, pra, të ndihemi të vetëmjaftueshëm e të vetëkënaqur nëpër ‘mëhallët’ tona krijuese e kulturore”. Kim Mehmeti flet për muret që janë ngritur qysh në dekadat e socializmit, që e vulosën mendësinë tonë, që ishte muri i lartë ideologjik që ngritën Enveri dhe Titoja. Dhe ky shkrimtar nuk e ka të lehtë të mbërrijë në arsyen se kultura e një populli që është ndarë me dekada nuk mund të integrohet në atë europiane apo botërore po nuk pati integrimin brenda vetvetes. Krijimi i “familjes së madhe” kulturore që pretenduan dy ministrat të shprehnin në marrëveshjen e këtij viti duket se e tregon më ironike këtë hapësirë. Në këto përpjekje të sforcuara, së paku prej shkrimtarëve, pranohet realiteti se letërsia shqipe është një e tërë, e pamundur të ndahet në provinca letrare, duke besuar se libri dhe botimet janë të parët që e kanë integruar hapësirën tonë kulturore. Shkrimtari Mehmet Kraja, për shembull, është një prej tyre, kur thotë se “bëj letërsi shqipe dhe i referohem një lexuesi të supozuar të mbarë hapësirës shqiptare. Dhe, pikërisht, sa i përket gjuhës, ndihem i barabartë me çdo shkrimtar shqiptar që shkruan në Tiranë, ose kudo gjetkë”. Kraja thotë se tani, së paku, nga letërsia e Kosovës ka mbetur vazhdimësia e një përvoje letrare, e cila gradualisht po integrohet në letërsinë e gjithmbarshme shqipe. Por, edhe kjo dyshohet. Pas kësaj përpjekjeje individuale të Krajës, një tjetër akademik nga Kosova, Eqrem Basha, është shprehur se komunikimet tona, paradoksisht ende janë të vështira e të pamjaftueshme, se autorë të Kosovës, të rëndësishëm, gati nuk njihen në Shqipëri dhe botimet që dalin andej me shumë vështirësi gjejnë rrugën për te lexuesi në Shqipëri. Në të dyja anët, pjesa e njerëzve jashtë politikës thonë se panairët e librit janë të vetmet mundësi për komunikime pak më të afërta, por që nuk mjaftojnë... Të tjerat janë shkëmbime projektesh, secila më vete pa lënë gjurmë apo kontekstualizuar hapësirën e përbashkët kulturore, aq të përfolur, siç qenë tekstet shkollore, historia apo edhe letërsia. Mungesa e këtij integriteti, ku me të drejtë është vërejtur se nuk gjen një gazetë tiranase në Prishtinë dhe një prishtinase në Tiranë, e bën pothuaj të pabesueshme edhe paraqitjen politike të dy ministrave që shfaqen herë pas here në agjenda projektesh, pa strategji të përbashkët. (V. M.)

TEMPUJT LETRARË TË ISMAIL KADARESË

Nga Zuvdija Hoxhiq



I kandiduar me vite për çmimin Nobel në letërsi, Ishkrimtari shqiptar më i njohur dhe më i rëndësishëm, Ismail Kadare, ka lindur në vitin 1936, në një familje të varfër nëpunësi. Ka studiuar gjuhë dhe letërsi në Institutin Shtetëror në Tiranë dhe pastaj në institutin “Maksim Gorki” në Moskë. Në moshën 18-vjeçare ka botuar përmbledhjen e parë poetike “Frymëzime djaloshare”, për t’iu kushtuar më vonë prozës, romaneve dhe tregimeve. Ka botuar romanet “Kështjella”, “Pallati i ëndrrave”, “Kronikë në gur”, “Dimri i madh”, “Nëntori i një kryeqyteti”, “Dasma”, “Muzgu i perëndive të stepës”, “Koncert në fund të dimrit” etj. Kadareja njihet edhe si tregimtar, poet, eseist, teoricien letërsie dhe kritik. Është anëtar i disa akademive. Është fitues i çmimeve ndërkombëtare, mes të cilave Man Booker International Prize, të Princit të Asturiasë dhe i Legjionit të Nderit të Francës etj. Nga dhjetori i vitit 2018 është anëtar nderi i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Malit të Zi. Libri i tij i parë, “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, e ka bërë shkrimtarin shqiptar më të lexuar. Njëherazi edhe më të njohurin në Europë. “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” është përkthyer në rreth tridhjetë gjuhë dhe ka zgjuar interesim të madh edhe për veprat e tjera të tij. Kadareja është shkrimtari që afirmon vlerat shpirtërore, etike e njerëzore dhe traditën e popullit shqiptar, por edhe kritik i regjimit diktatorial dhe i pushtetit në vendin e vet. Në Shqipërinë e Enver Hoxhës, në të cilën e gjithë kultura ka qenë nën kontrollin ideologjik, ndërsa letërsia e robëruar nën pasqyrimin soc-realist të realitetit, Kadareja ka futur risi dhe përvoja moderne të romanit europian, gjë që për letërsinë europiane ka qenë normale, e natyrshme, kurse në atë shqiptare ka shënuar avangardën dhe në letërsinë e saj ka pasur ndikim të fortë, mund të thuhet – reformator, edhe në planin tematik-përmbajtësor, edhe në atë estetik. Me çdo libër të ri, Kadareja ka luajtur me formën, duke eksperimentuar me sukses dhe duke zgjeruar kufijtë e procesit dhe përvojës krijuese. Por nuk e ka bërë kjo të njohur në Shqipëri, aq më pak në Europë dhe në botë. Famën e shkrimtarit të madh e ka arritur me veprat, të cilat kanë plotësuar kriteret më të larta estetike, si dhe tematikën e lidhur me mileun social-kulturor shqiptar, ngjarjet dhe personalitetet historike. Në jetë, si edhe në art, asgjë nuk është e rastësishme. Italianët e kanë përkthyer “Gjeneralin e ushtrisë së vdekur” pothuaj afërsisht me botimin e tij në gjuhën shqipe; francezët menjëherë pas tyre. Befasia ka qenë sensacionale. Vallë, a është e mundur që një shkrimtar të tillë ta lindë një popull, kultura e të cilit është shikuar me paragjykime dhe skepticizëm? Vallë, a është e mundur që nga vendi më i izoluar në Europë, i rrethuar me tela me gjemba, i mbushur me bunkerë, ku prodhoheshin vazhdimisht armiq të brendshëm, në të cilin për shkak të vuajtjeve të një njeriu të pafajshëm, kanë vuajtur edhe dhjetë të tjerë të pafajshëm me pastrime partiake, burgosjen e më të merituarve dhe më të mirëve, të shfaqet një shkrimtar i tillë.


I lavdëruar dhe i kritikuar, i botuar në tirazhe

të mëdha e të pazakonshme, por edhe i ndaluar, nën frikën e arsyetuar se edhe ai mund të bëhej viktimë, Kadareja, për të shmangur atë më të keqen dhe që të mund të shkruante, disa libra i ka shkruar nën frymën e ikonografisë së realizmit socialist ose është angazhuar politikisht në parti, në tribuna dhe në kongrese. Ka mundur të heshtë, si Lasgush Poradeci, për të cilin që në vitin 1929 Eqrem Çabej ka thënë se është një poet që letërsia shqiptare do ia dhurojë një herë botës, por që për dyzet vjet të sundimit komunist nuk botoi asnjë varg. Ka mundur, por ky veprim do t’i sillte një dëm të pafalshëm dhe të pazëvendësueshëm. Kadareja e ka ditur këtë. Ndoshta edhe për këtë shkak i ka rrëshqitur edhe çmimi i Nobelit. Në të gjitha rastet, shkaqet kanë qenë jashtëletrare. Në ato intervale kohore shkruan romanet “më pak” të rëndësishme, “Dasma”, “Nëntori i një kryeqyteti”, “Dimri i madh” dhe “Koncert në fund të dimrit” – mbi fundin e një “miqësie shekullore” mes Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik, respektivisht Shqipërisë dhe Kinës. Aprovimet, tumirimet, duartrokitjet dhe përshtatjet, sigurisht, i kanë ardhur më rëndë se të tjerëve, për shkak të forcës eruptive të talentit të tij dhe besimit se është i lindur të jetë “Homeri i Ballkanit”. Për këtë, ndeshjen me vetveten e ka pasur më të vështirën. Ka fituar me të tjerët dhe me veten duke shkruar kryeveprat, siç janë “Kështjella” dhe “Pallati i ëndrrave”, krahas romanit të shkruar më parë “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”. “Pallati i ëndrrave” dhe disa libra të tjerë, me paraqitjen alegorike të totalitarizmit dhe diktaturës, nuk kanë mundur t’u shpëtojnë zhdanovëve të ngurtë ideologjikë. Është

e çuditshme si nuk ia kanë përfunduar karrierën me izolim ose me burg. Dhe më e madhe është çudia se nga më e keqja e ka mbrojtur i vetmi që e ka pasur një mundësi të tillë – Enver Hoxha!

Kjo, dhe akoma më shumë fama botërore, e kanë çliruar nga “dinakëritë” dhe frika nga dënimi. Duke kuptuar se sa dëm, por edhe fitim, mund të kishin prej tij, pushteti e ka lënë në qetësi. Kadareja shkruan “Pashallëqet e mëdha”, roman për Ali pashë Tepelenën, kryengritësin kundër pushtuesit osman, i cili për njëzet vjet ka sunduar në Janinë dhe popullit i ka vënë një sundim të frikshëm e mizor, më të ashpër se ata prej të cilëve e ka çliruar. Ka qenë kjo më shumë se një aluzion i qartë në regjimin diktatorial në Shqipëri. Sigurisht që kjo nuk do t’i falej, por Kadareja veç ka qenë i sigurt, në Francë – kandidat për çmimin Nobel. E kanë siguruar “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, “Kështjella” dhe veçanërisht “Pallati i ëndrrave”.

“Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, kryevepra e parë, sipas shumë shkruesve, është vepra e tij më e mirë, moderne, e shkruar me stil origjinal, e cila për nga thjeshtësia të kujton Heminguejin, gjegjësisht Gogolin dhe klasikët rusë, të cilët i ka studiuar gjatë studimeve në Moskë. Por edhe shkrimtarët modernë të Europës, që rusët i kanë përkthyer me kënaqësi. “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” është, sipas temës, përmbajtjes dhe mesazheve antifashiste dhe antimilitariste, sa universal dhe gjithënjëzësor, aq edhe odë e himn për njerëzit dhe popullin shqiptar. Njëzet vjet pas Luftës së Dytë Botërore, një gjeneral i ushtrisë okupuese vjen në Shqipëri të mbledhë kockat e ushtarëve fashistë për t’i kthyer në vendin e tij. Bashkë me një prift që ka qenë më parë në Shqipëri, gjurmon në varre, identifikon ushtarët e vdekur, duke vënë eshtrat e tyre në thasë. I vënë përballë popullit që ka mbrojtur lirinë, i përgatitur për të marrë mbi vete gjithë sakrificat, në takimin me njerëzit të cilëve okupatorët u kanë vrarë më të afërtit, gjenerali ballafaqohet me ndërgjegjen e vet, rishqyrton qëndrimet e tij njerëzore dhe ushtarake. Njohja me njerëzit, me traditën e tyre, zakonet, këngët, mikpritjen, guximin dhe moralin, bëjnë që gjithnjë e më shumë t’i kuptojë dhe vlerësojë. Përmes arsyetimeve të tij, bisedave dhe shmangieve të priftit, Kadareja, me qëndrimin e një artisti të madh, njohësit të mentalitetit dhe karakterit të bashkëkombësve, përmes skenave dhe personazheve episodike dhe veprimeve të tyre zbulon dramën e thella dhe fuqinë e frymës së vetë bashkësisë dhe të popullit. Duke kaluar dhe duke gjetur vendet ku janë varrosur ushtarët okupues, gjenerali në veçanti gjurmon pas kolonelit Z, me familjen e të cilit ka marrëdhënie miqësore. Thesin me eshtrat e saponxjerra nga dheu të kolonelit do t’ia hedhë para këmbëve plaka e prishur nga nervat, në mes gëzimit, në një dasmë fshati, duke zbuluar se koloneli i ka vrarë të shoqin dhe përdhunuar të bijën... Dhe se kjo u ka marrë hakun! Në një rast tjetër, mullisi i fshatit do t’i japë gjeneralit ditarin e dezertorit ushtarak të cilin e ka mbajtur të fshehur, por pjesëtarët e “Batalionit blu” e kanë zbuluar dhe e kanë vrarë. Ushtari, si e kanë quajtur në fshat, ka



shënuar në ditar ndjenjat dhe përjetimet e veta, duke dëshmuar mbi fisnikërinë e të gjithëve, veçanërisht gruas së mullisit, “Teto Katës”. “Ajo më bën pyetje për gjëra të ndryshme. Unë i tregoj për prindërit, të mitë e afërt dhe shtëpinë, sa më ka marrë malli për ta, ndërsa ajo më sheh e mërzhitur dhe bën shenjë me kokë. I ziu djalë, thotë në fund dhe shkon të mbrujë bukën ose të lajë enët”. Kadareja është mjeshhtëri i tërësisë dhe i detajit. Në mes të tregimit, duke e bërë atë më interesant, fut me mjeshhtëri ndonjë “sekuencë” si ajo me malësorin Nik Martini, i cili krejt i vetëm, i frymëzuar me heroizmin e personazheve të traditës dhe epikës shqiptare, shkon të ndeshë brigadën e okupatorit “që të vritet me të”. Duke ndërruar me shkathësi pozicionin dhe duke gjuajtur, i mban me orë të tëra dhe i provokon. Të tërbuar dhe të pamundur që t’i afrohen, e gjuajnë me minahedhës... Ai nuk ka varr. Ai jeton në një nga këngët, të cilat kanë lënë mbi gjeneralin përshtypje të veçantë, për të cilat mendon gjatë, i bindur se i kupton. I turpëruar me krimin e kolonelit, gjenerali e hedh në lumë thesin me eshtrat, edhe pse është i ndërgjegjshëm se padija e priftit do ta çojë në gjyqin ushtarak dhe do ta mbështjellë urrejtja e familjes së kolonelit. Telegramin që ia kanë dërguar veteranët e luftës, pas përfundimit me sukses të operacionit, gjenerali as nuk do ta shikojë, do ta zhubrosë, do ta grisë dhe do ta hedhë nga dritarja. Ndërsa në të ka qenë e shkruar: “Përsëritje gjestin Tuaj...”.

“Gjenerali i ushtrisë së vdekur” dhe “Kështjella” kanë “ngjyrë kombëtare” dhe apologjetë, por edhe me këtë arrijnë që lexuesi i huaj t’i pranojë me simpati dhe emocion. Sepse janë vepra të mëdha artistike dhe për këtë dallohen nga librat e tjerë të Kadaresë me “temë të ngjashme”. “Kështjella”, roman mbi fushatën pushtuese osmane mbi Shqipëri dhe rrethimin e qytetit të Skënderbeut, kundër të cilit pushtuesit nisen me një fuqi ushtarake dhe teknike të paparë deri atëherë, me topa të rinj të derdhur, me njësitë e jeniçerëve, azapë, eshkinxhinj, akimxhinj, kurdë, tartarë, kallmikë, pjesëtarë të “Repartit të vdekjes”, të cilët kthehen nga luftërat ose fitimtarë ose të vdekur. Ndërpresin sjelljen e ujit në kështjellë, hapin tunele që t’i pushtojnë nga brenda, hedhin minj që të nxisin mortajën, helmojnë ujin, por kështjellën nuk mund ta marrin. Skënderbeu nuk është brenda, është diku afër ose në male, i padukshëm, i paparashikueshëm, i gatshëm që në çdo moment të godasë mbi llogoret osmane. Sulmet e tij të natës provokojnë panik dhe vdekjen e qindra ushtarëve armiq, fusin frikën në eshtra. Si shfaqet, ashtu edhe zhduket, por mbrojtësit dhe sulmuesit e dinë se ai është kudo. Disa edhe nga përmendja e emrit të tij i kap tmerri, të tjerëve u jep forcë dhe i bind se janë të pamposhtur.

Në roman nuk ka përshkrim të figurës së tij, por ai nuk është i pafigurshëm. Përkundrazi, ai identifikohet me popullin. Njerëzit që sipas traditës dhe ndërgjegjes epike do të kishim më shumë arsye për ta përjetuar si qenie mitike, e shohin si një njeri të zakonshëm. Por kur si të tillë e përshkruan oficeri osman, i cili e ka parë gjatë një rasti në bisedë me Sulltanin, simbolika e unitetit të popullit me udhëheqësin është më shumë mbresëlënëse dhe e natyrshme. Nuk ka në “Kështjellë” as emra të komandantëve të Skënderbeut, as luftëtarë. Ata janë një. Ata janë populli, i cili edhe pse i paktë me numër, tregon se edhe “të vegjlit” mund të kenë rol historik dhe të ndikojnë në ngjarjet botërore. Prandaj në “Kështjellë” defilojnë shumë personazhe osmane – që nga komandanti kryesor Tursun Pasha, kronisti Mevla Çelebia, astrologë, shkruar, komandanti i jeniçerëve Tuz Okçan, mekaniku Saruxhe, mjeku Siri Selim, inxhinier Kauri dhe të tjerë, emrat e të cilëve do t’i fshijë koha. Ata do të shkojnë, të tjerë do të vijnë e arrijnë, por do të kthehen të mundur. E kupton këtë edhe komandanti kryesor me emrin e plotë, i quajtur Ugrulu Tursun Tunxhaslan Sert Olug Pasha, të cilin pas sulmit të dështuar e pret heqja e “pikëllimit”,

brezi i mëndafshhtë ose poshtërimi e degradimi. Ai vetëvendos, tërhiqet në çadër, dëshiron të mos jetë më, pi pluhurin e helmit, duke menduar “për jetën e tij të shkurtër dhe për gjithçka që ka bërë, për shpirtin që po i shkon në atë jetë dhe për Skënderbeun që mbetet në këtë jetë...”

Mbi “Pallatin e ëndrrave”, kryeveprën e cila, nëse nuk është më e mirë se “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” dhe “Kështjella”, gjithsesi është në atë rrafsh, ka shënuar: “Ka kohë që më ka tërhequr projektimi i një vizioni të ferrit. E di se kjo është e vështirë, për të mos thënë e pamundur, që të krijoj diçka origjinale pas arkitektëve të deritashëm të ferrit, siç kanë qenë egjiptianët anonimë, Homeri, Shën Agostini ose Dantja. Sa më shumë që kam menduar për këtë, e kam pasur gjithnjë e më të qartë se bëhet fjalë për njëfarë mbretërie vdekjeje të krijuar nga gjumi dhe ëndrrat tona, pra nga pjesa e pëtejme e qenies sonë e cila, paralelisht dhe njëkohësisht, jeton pranë nesh... Kanë qenë këto ankthe, përpëlitjet e ndërgjegjes, shpresat e humbura. Por, mbi të gjitha, ka qenë aty edhe ai shkallëzimi administrativ, sektorët mbi të cilët kanë qenë të detyruara të kalojnë ëndrrat, për t’u studiuar



e interpretuar me themel, çfarë e ka bërë ndërtesën e “Pallatit të ëndrrave”, në njëfarë mënyre, më të afërt me strukturën e ferrit dantesk...”

Është e vërtetë se tema e ferrit nuk është e re, por është e re mënyra me të cilën Kadareja realizon vizionin e vet për ferrin. Në të vërtetë, regjimin në të cilin ka jetuar, totalitarizmin, kontrolli i gjithçkaje dhe i gjithkujt. I ndërgjegjshëm se, edhe pse në majë të Partisë dhe shkrimtar i njohur, mund të bëhet viktimë, jo për shkakun e vet sa nga të tjerët, Kadareja mendon se si shkrimtar dhe njeri t’i kundërvihet diktaturës. “Krijon” duke frikësuar institucionin në të cilin do të mbledhë, do të ruajë, do të klasifikojë dhe do të studiojë ëndrrat e çdo individi, grupi e populli në Perandori. Ideon “Pallatin e ëndrrave” – Tabir Sarajin dhe e vendos në kohën e kaluar, në qendër të Perandorisë Osmane, në sistemin e mbyllur të despotatit oriental. Në Tabir Saraj, arkivin me dosje të panumërta ëndrrash, ku gjithçka është e regjistruar, fillon të punojë Mark-Alem Qypri, një pinjoll i një familjeje vezirësh të fuqishëm shqiptarë. Mbiemri i tij shqiptar është “shifra” që e lidh me “Tokën e shqiponjave”, paraqitjen alegorike të regjimit diktatorial të Enver Hoxhës. Derisa njeri nga administratorët e nje me funksionimin e sektorëve në “Pallatin e ëndrrave”, rangimin dhe shkallëzimin e

shërbimeve, ndikimin dhe rëndësinë e tyre, shpeshherë i përsërit: “Mos mendo se mbi ta nuk ka të tjerë...” dhe “se pranë Tabirit të zakonshëm ekziston edhe një Tabir ëndrrash i fshehtë, nga të cilët ka ardhur shteti në mënyrën dhe metodat e veta...”

Mark-Alemi nga një “evidentues i thjeshtë” do të përparojë gjithnjë, duke fituar vende më të rëndësishme e më me ndikim, në fund edhe drejtues i “Pallatit të ëndrrave”. Kur e thërrasin të paraqitet në Seksion ose në Administratë, edhe ai, si të tjerët, më përpara ka menduar se më parë e pret dënimi ose shkarkimi, sesa ngritja në përgjegjësi. Që në fillim të shërbimit ka qenë dëshmitar se si për një diçka fare të vogël, për një interpretim të gabuar të gjumit, vriten anëtarët e familjes së Qypriëve të fuqishëm. Derisa një pasdreke pranverore vozitet me karro para parkut qendror, duke shikuar nga dritarja, Mark-Alemi, në kulmin e fuqisë, frikohet dhe e di se “ata do të vijnë e ta marrin për ta çuar atje, nga ku nuk ka kthim...”. “Mund të porosis menjëherë që mbi varr të më gdhendin një degë sallgami në lulëzim”, - thotë me vete. Gati të gjithë ata që kanë shkruar për “Pallatin e ëndrrave” e krahasojnë ose gjejnë ngjashmëri me

Ferrin e Dantes, ndoshta “të mashtruar” me Kadarenë me deklarin mbi strukturën infernale të “Pallatit të ëndrrave”. Kjo afërsi është vetëm formale. Sektorët e seleksionimit, sektorët e interpretimit, interpretuesit e mëdhenj, arkivi, shpërndarja e hapësirave, korridoret sekrete, sallat e shumta në “Pallatin e ëndrrave” mund të ngjajnë me “hinkën” e shkallëve horizontale, rrathët dhe këndet e Infernit të Dantes, por ndryshimi mes tyre është i madh. Në sarajin Tabir janë ëndrrat – ferri është jashtë mureve të tij, në Tokë, në shtet; kurse ferri i Dantes është në brendësi të Tokës, në hinkë. Në ferrin e Dantes janë vetëm mëkatarët, kurse në ferrin e Kadaresë – të gjithë. Prandaj është më i frikshëm dhe më i rrezikshëm. Në ferrin e Kadaresë mund të gjendet gjithkush, të pafajshmit para mëkatarëve dhe fajtorëve. “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, “Kështjella” dhe “Pallati i ëndrrave” janë kryevepra të cilat e kanë promovuar Ismail Kadarenë jo vetëm si shkrimtarin shqiptar më të madh e më të rëndësishëm ose si “Homerin e Ballkanit”, por edhe si shkrimtarin udhëheqës bashkëkohor europian dhe botëror. Ai nuk është njëri nga më të mëdhenjtë. Kadareja është – më i madhi.

Përktheu: Dimitrov Popoviq

ATI IM ISHTE NË DALMACI

Nga PIERFRANKO BRUNI

Ati im më rrëfeu. Ndodhej në Dalmaci. E kishte anjohur D'Anuncion në moshën 15-vjeçare me xhaxhain kolonel. Më pas kishte shkuar në Istria. D'Anuncio ishte mik i kolonelit Agostino Gaudineri. Ati im një armik? Ishte thjesht një fashist, ndërsa koloneli ishte një përkrahës i Savojës. Pas tradhtisë së Këshillit të madh, ati im, nga njëra anë, republikan me Beniton, xhaxhai me mbretin. Të gjitha ditët mund të ngjasojnë. Ka ditë të ndryshme që marrin formën e vdekjes, të tjera të kujtesës! Ndonjëherë frymëmarrja e natës bëhet e rëndë. Nuk duhet ta dëgjosh. Zërat bëhen melankolikë. Ka histori që rrëfihen dhe tregime që nuk duhet ta kenë një vend në histori dhe që nuk duhet të shndërrohen në histori. Fati ecën mes thyerjeve të kohës dhe gjithçka bëhet e vërtetë ose fikcion. Fjalët gërshetohen në ditët e trishta të historive tragjike që kanë gropa gjaku. Unë po hedh në të pastër gjithçka që mbajta shënim në një fletore, ndërsa ati im më fliste ngadalë. Kënga e trishtë kthehet, nuk i ankohet kujtesës. *Qëllojnë prapa maleve/ të shtëna mitralozi/ përplasen me tentakulat e vdekjes. Komunistët/ masakrojnë/ telat me gjemba, i lidhin kyçet dhe këmbët, mes duarve./ Komunistët titistë/ komunistët titanë, në rrjetën e komunistëve italianëve. Qëllojnë/ i qepin duart me tel hekuri dhe zemra është metal llamarine në histori.*

Ka histori, histori të tjera që ravijëzojnë tragjeditë dhe tragjeditë nuk rreshtin së rrjedhuri si gjaku përtej vetë kujtimit...

Dëgjoj!

Iliana: “Unë të pres dhe nëse agu do të mbërrinte para teje, do të nis të eci. Do të vij të të kërkoj...” Gabrieli: “Mos e bëj. Unë do të kthehem. Mos e merr udhën. Rruga është në histori. Ne jemi të mundurit dhe hapësira e udhëtimit nuk ka gjeografi...”

Në një letër drejtuar atit tim, mes faqeve të një fletoreje me kapak të zi, gjeta një shënim. Lexova: Ato ditë na çrrënjosën. Kush mbeti, lëshoi një klithje gjaku mes shkëmbinjve karstikë, ku kujtesa pengohet në gozhdën e zemrës. Pasoj heshtja dhe maskat që s'pushuan së shkurtuari fjalët. Ishte historia realiteti fajtor i një të vërtete të heshtur. Ato ditë na çrrënjosën nga zëri dhe fati. Të tjerë, shumë të tjerë, emrat e të cilëve ndodhen në përshkrimin e tragjedisë që precipituan të gjallë në gurët e vdekjes... Dhe frynte erë. Po atë ditë. Ishte kohë pranvere. Dielli digjte mbi shtëpitë e fshatit dalmat. Lufta kishte marrë fund, por për Titon dhe Jugosllavinë komuniste asgjë s'kishte marrë fund. Kolaboracionistët toliatianë ishin në dijeni të krimeve. Iliana gjithë ditën kishte qëndruar të korrte barin i cili ishte rritur përtej derës së kopshtit dhe që e rrethonte shtëpinë. Gabrieli studiointe për ta përcaktuar temën e tij të diplomës. Ishin italianë. Nuk kishin qenë kurrë fashistë. Edhe në luftën partizane nuk kishin marrë pjesë. Të dashuruar me dashurinë dhe idenë e atdheut që ishte për ta flamuri i një ideali në emër të bashkëndarjes së thellë të vlerave kristiane. Gabrieli mbante në qafë Kryqin e Shën Françeskut të Asizit. Iliana shkonte çdo mëngjes në një kishë të vogël të fshatit që të lutej dhe që t'i besonte dhuratës së besimit. Çdo mëngjes. Lufta dukej larg, imagjinohej ose mendohej e mbaruar. Italia ishte shpallur republikë. Një natë mbërritën te gardhi i shtëpisë dy makina.

Zbriti “Ushtria e kuqe” në emër të lirisë komuniste. Masakruan lepuj, pula dhe një qen që lehte më shumë seç duhej, u qëllua më një plumb në kokë. Gabrieli dhe Iliana papritur u zgjuan nga zhurma e plumbave. Ishte një fatkeqësi. Tragjike. Ia behën para shtratit tre burra të armatosur me pushkë dhe automatikë, me guxim prej komunisti. Ishin tre titistë dhe një italian. E mori fjalën italian: Gjykata komuniste iu bëri procesin dhe iu dënoi. U gjykuat fajtorë. I shtynë jashtë dhomës. Iliana ishte me këmishë të tejdukshme, një këmishë rozë, ndërsa Gabrieli ishte vetëm me të mbathurat. I shtynë nga njëra dhomë në tjetrën. Me shkelma, grushte, pështyma. Iliana u pengua shumë herë nga shkelmat e tre trimave të kuq që, me pushkët e drejtuar, i shtynin të dy të dashuruarit. Cili ishte faji i tyre? Thjesht ishin italianë. Në tryezën e kuzhinës ishin të shpërndarë disa libra që i duheshin Gabrielit, me qëllim që ta përfundonte tezën që mbante titullin “Dantja në humanizmin e kulturës”. I grisën librat. Dosjet. Fletët. Gazetat.

I shoqëruan Gabrielin dhe Ilianën në një kamion ushtarak, me një banderolë me drapër e çakan dhe me yllin e kuq. Komunistët titistë dhe komunisti italian u rikthyen në shtëpi, grumbulluan gjithçka në mes të oborrit. Karriget e pakta, tryezat e vogla, rrobat, librat dhe ua vunë zjarrin. Ia vunë flakën gjithçkaje. Kur pa grykën e parë të flakës, Iliana thirri: “Kjo është e gjithë pasuria që kam.”

Me një gjuhë të pakuptueshme një titist, me pushkën në dorë, qëllloi disa herë duke thënë: “Në varr nuk do të të hyjnë më në punë.” Kamioni u nis. Ilianën dhe Gabrielin i lidhën me litarë në parmakët e brendshëm anësorë të kamionit. Mbërritën në një zonë shkëmbore. I zbritën. Ua lidhën sytë. Dolën dy plumba pistolette të drejtuar në këmbët e Ilianës dhe Gabrielit. Me një litar tjetër i lidhën për beli dhe i hodhën në një gropë mes shkëmbinjve. Aty kishte trupa të tjerë dhe ankimet gërshetoheshin me jehonat e ankimeve të tjera. Për Ilianën dhe Gabrielin s'u morr vesh më asgjë. Edhe tani nuk dimë gjë. Në shtëpinë e djegur kishte vetëm hi. Hi dhe erë. Disa kohë më pas, në verë, gjetën një fletë të zverdhur. Kishte ngecur mes degëve të një ulliri. Kishte një shënim: “Dantja dhe kultura e humanizmit.” Thjesht ishin italianë. Për vite askush nuk u kujtua për të vdekurit e kallur në foibe*. Përkundrazi, të gjallët e kallur nga dora komuniste. Historia nuk përsëritet, por historia duhet rrëfyer. Iliana dhe Gabrieli mbetën të zënë në kurth nëpër foibe. Nga dashuria për Italinë, edhe ndërgjegjet tona nuk

duhen harruar. Ishte pranverë dhe më pas vera e vitit 1947. Një histori e vërtetë, një e vërtetë në histori, një tregim mes copave të gazetave? Ati im, mes rrëfimeve të shumta, ma besoi këtë detaj historik dhe ekzistence. Edhe këtë rrëfim ma besoi ati im... Koha është një shifër që ngulitet në zemrën tonë.

Iliana: “Ja ku u takuam përsëri. Por jemi erë dhe hi që rrëfejnë...”

Gabrieli: “Historia ndonjëherë flet, por shumë herë harron...”


Iliana: “Mos harro kurrë. E vërteta është një pakt gjaku!”

Ende dëgjoj një këngë të trishtë që thotë: *Jeto/ në foibe/ i masakruan italianët/ Pola, Istria, Trieste/ sa bien erë zjarri, gjaku/ trëndafilat e Dancikës. Qëlluan komunistët në zverk/ sa klithje në shpellat karstike? Gënjeshtro gjendet në histori dhe historia thotë gënjeshtro.*

Tashmë koha ka kaluar. Koha kalon gjithmonë dhe kujtesa bëhet e akullt, por ato masakra dhe ai gjenocid e prenë jo vetëm historinë: “Historia e rrëfyer është gënjeshtër.”

Gënjeshtro ka maska të hekurta, por nuk ka kuptim të flasësh për harresën. Era shpalos fytyra. Ati im më fliste ngadalë. Çfarë ishin foibet? Masakër ndaj atyre që kërkonin të drejtën të njiheshin si italianë. Secili prej nesh e ka detyrën të rrëfejë. Por secili prej nesh të dëshmojë. Kush jetoi dhe di, e ka detyrën të mos heshtë! Ati im nuk jeton më. Fjalët e tij këmbëngulin si një daulle në kohën time. Jehona. Historia po dobësohet. E vërteta është një pakt gjaku! Nuk ekziston një histori e pranuar nga të gjithë. Aq më pak një imagjinatë kolektive. Nga njëra anë, kush fiton, gjithmonë e ka tradhtuar të vërtetën dhe sajojnë rrethimin e imagjinatës. Përkundrazi, e pushton imagjinatën. Të mundurit rindërtojnë një histori tjetër. Besnikëria është një elegancë që nuk njihet më! “Besnikëria është një akt kuraje që u përket atyre që e njohin koherencën”. Kështu më foli ati im, pasi më tregoi aventurën tragjike të Ilianës dhe Gabrielit.

Përgatiti për botim
Arjan Th. Kallço



LLAVA SONORE E VAÇES...

Nga Aleksandër Peçi

Më 7 prill u mbushën 80 vjet nga lindja e artistes së këngës, më e madhja e të gjitha kohërave në Shqipëri, Vaçe Zela. Cilat ishin arsyet që e bënë Vaçe Zelën artisten më të madhe të të gjitha kohërave në zhanrin e këngës, të dominojë këngën shqiptare për një gjysmë shekulli? Llava sonore e Vaçes shkrinte e drithëronte shpirtrat e shqiptarëve dhe do të vazhdojë ta bëjë. Argumentet do t'i ndaj në dy grupe.

Së pari, ato lidhen me aparatin vokal, fizik e gjenetik, ndër të cilat do të përmendja:

1. Aftësitë e veçanta vokale që lidhen me kordat, gojën e madhe, timbrikën dhe ngjyrën e zërit, i cili kalonte nga nuancat më të brishta e poetike, një shkëlqim të briliant të vokalit, deri në shpërthimin vokal, për të cilat mbetet e papërsëritshme dhe e paimitueshme.

2. Supertalenti i cili i kapërceu kufijtë e shkollave, u bë vetë shkollë dhe krijoi me kompozitorët dhe poetët profesionistë modele më të mira të këngës shqiptare, të cilat kurrkush nuk e pati aftësinë t'i arrinte, jo më t'i kapërcente.

3. Aparati fizik: ekspresioni, forca interpretative, sharmi, gjestikulacioni i duarve, gjatësia e trupit, qëndrimi me dy këmbë të hapura e të mbështetura fort në tokë si të ishte një Ante femër dhe kombinimi i tyre me dy duar të hapura e kokën lart nga qielli. Ajo gojë e madhe të cilën muskulatura dhe emocioni e zmadhonte edhe më shumë, duke i dhënë maksimumin akustik, e cila e bënte ta shpërthente si vullkan llavën sonore që i dilte nga shpirti.

4. Aftësia e rrallë që Vaça kishte për të kulmuar në këngë, me kulminacione që rrëqethnin cilindo që e dëgjonte.

5. Hiperemocioni që ajo kish në skenë sa herë dilte para publikut. Vaça s'pranonte që, për arsye të mungesës së publikut, të regjistronte në studio. Vetëm dy këngët e filmave të mi i ka regjistruar në studio, "Në shtëpinë tonë" dhe "Fillim i vështirë".

Së dyti, arsyet lidhen me aparatin intelektual e kulturor.

1. Informacioni kulturor i saj ishte i gjithanshëm. Ajo lexonte letërsi, poezi, por veç tyre do të veçoja se Vaça ndërthuri në një kohezion unikal disa kultura: a. këngën fshatare, myzeqare kryesisht, por edhe më gjerë; b. këngën qytetare; c. këngën europiane, spanjolle, italiane, franceze. Ishte koha kur Vaça 20 vjeçe e çmendte publikun me kitarën e saj duke kënduar "Esperanca" e të tjera këngë. Kohë e cila, në fund të viteve 50-të dhe në fillim të viteve 60-të, shoqërohej edhe me një lloj liberalizmi, ku perla të kulturës europiane ishin oksigjen kulturor për publikun.

2. Inteligjenca dhe intuïta e fortë e saj për të çmuar e për të kërkuar arin e tingujve që krijonin kompozitorët: Gaci, Prodani, Dizdari, Krajka, Daija, Laro, Ibrahim, Kushta, Zoraqi, Peçi, Kodra, Grimci, dhe arin poetik që krijonin poetët Agolli, Arapi, Spahiu, Beci, Lako, Jorganxhi, Blushi etj., sqima dhe gustoja e saj absolute dhe absolutisht profesionale në përzgjedhjen e materies kompozicionale e poetike. Vaça ishte si ajo bleta që shkonte e thithte pikërisht atë nektar muzikor dhe atë nektar poetik. Duke e përpunuar në aparatin e saj vokal e *mental la modele* që jo vetëm sot, jo vetëm këta 60 vjet, por edhe 100 vjet të kalojnë, ajo do të mbetet mbretëresha e këngës shqiptare.

3. Vizioni i saj për ta tërhequr publikun drejt modeleve që ajo krijonte së bashku me kompozitorin profesionist dhe poetin profesionist. Sot në Amerikë nuk quhet kompozitor ai që shkruan këngë, por quhet *songwriter*. Kompozitor është fjalë e madhe që peshon shumë. Duhet të kesh marrë titull, diplomë të shquar, të kesh një katalog shumë të pasur veprash. Vaça nuk binte kurrë në nivelet e shijeve të tregut a të komercit,

nuk binte në nivelet e *songwriter*-it. Ajo ishte ithtare e këngës jetëgjatë, këngës profesionale dhe këngës vizionare që hapte shtigje të reja e sillte modele të reja. Dhe koha tregoi se këngët e saj i rezistuan dhe do t'i rezistojnë jetëgjatësisht kohës. Koha që Vaça jetoi ishte një kohë, një Epokë, ku ajo ndërtoi vizionin e saj për këngën. Nuk ishte koha e këngëve *fastfude* apo këngëve *patatina* që i ha dhe i hedh poshtë pas pak çastesh, siç është mbushur panorama e këngës sot.

4. Inteligjenca e çoi Vaçen te këngët me të cilat lidhej shpirtërisht jeta e shqiptarit, jeta e kombit, ngjyra e flamurit, kjo lidhje midis Vaçes, shpirtit të saj dhe ngjyrës së flamurit, drithërimës së kombit, shqiptarizms dhe fakti që tekstit të këngës Vaça, si rrallëkush tjetër, dinte t'i nxirrte përmbajtjen, janë një arsye madhore e dominimit të saj për një gjysmë shekulli.

5. Vaça kish një aftësi të rrallë për të aktruar. Liceun e mbaroi për kanto, ndërsa të lartën për aktore, çka do të thotë se me inteligjencë e talent të gjithanshëm krijoi karaktere si askush tjetër. Vaça si një aktore e vërtetë dinte të bëhej një vajzë e vogël në timbër kur i



këndonte gjyshes, lozonjare te "Lemza" apo "Djaloshi dhe shiu", nostalgjike te "Ylli partizan" (të katërta këto këngë te Krajka), me zërin plot shkëlqim e dritë kur këndonte këngët e mia "Në shtëpinë tonë", "Rritim jetën tonë" dhe këngën e filmit "Fillim i vështirë". Me një atdhedashuri të jashtëzakonshme këndonte këngët e Feim Ibrahimit "O zambak i bardhë mbi gur" dhe "Rrjedh në këngë e ligjërimi", tepër moderne kur këndonte "Natën vonë" dhe "Flakë e borë" të Daijës, vullkanike kur këndonte këngët e Laros, me një romantikë dashurie kur këndonte "Mesnatë" të Kushtës apo "Nëno moj do pres gërshetin" dhe "Moj e bukur Arbëri", apo te "Vals i lumturisë" të Avni Mulës ose këngët Dizdarit e Prodanit etj., ku Vaça krijonte karaktere dhe nuk e përsëriste kurrë vetveten. Vaça iku me një peng. Njëherë më thoshte: "Më shumë duhej të kisha kënduar këngë për dashurinë." Koha që e tillë që mbi vokalin e saj do të mbështeteshin këngë të dimensioneve të mëdha e të problematikave të mëdha.

Personalisht, kam qenë i privilegjuar që Vaça u ka dhënë shpirtin e saj gjashtë këngëve të mia. Do të përsëris Niçen i cili thoshte: "Vlerat e mëdha duan interpretë të mëdhenj." Dhe ato u bënë njësh me emrin e artistes së madhe Vaçe Zela.

Duke e përmbyllur këtë homazh në këtë 80-vjetor të lindjes, siç e kish çdo gjë të paimitueshme e origjinale artistja e madhe, Nderi i Kombit, edhe emrin e kish të tillë. Vaçe, nuk e kam dëgjuar që asnjë person tjetër ta mbajë këtë emër. Është emri i përveçëm, i papërsëritshëm dhe zëri i Artistes së Madhe që do ta shoqërojnë shqiptarin edhe për shumë e shumë dhjetëvjeçarë të tjerë, zëri i Mbretëreshës së këngës Vaçe Zela. I kërkoj Bashkisë Tiranë që shtëpinë e Vaçe Zelës ta kthejnë në shtëpi-muze. Kjo është më e pakta gjë që mund t'i bëhet si shpërblim për gjithçka që Vaça i dhuroi kombit të shqiptarëve.

PËRKTHIMI

STEFAN ÇAPALIKU

Botohet në italisht "Secili çmendet simbas mënyrës së vet"


Nga Durim Taçi

Panairi i librit në Bergamo, Itali, këtë vit do të ketë të ftuar, për herë të parë, një shkrimtar shqiptar. Në sallën e madhe të takimeve, më 28 prill, prezantohet botimi në gjuhën italiane i vëllimit të parë të romanit "Secili çmendet simbas mënyrës së vet". Me këtë rast, Lubrina Bramani Editore, shtëpia botuese që tanimë zotëron të drejtat e botimit në gjuhën italiane, ka vendosur të ftojë autorin Stefan Çapaliku në këtë event. "Eksportet" nga Shqipëria drejt Italisë kanë ndryshuar, duke krijuar një imazh të ri të saj. Në këtë kuadër, prania e një shkrimtari shqiptar në Bergamo, në zemër të Lombardisë, tanimë vjen natyrshëm, interesimi është i madh. Të huajt kanë filluar t'i shikojnë shqiptarët ndryshe, apo janë ata që kanë ndryshuar? Që të dyja bashkë. Para se të zbarkonte në gadishullin Apenin, romani ka rrugëtuar në brendësi të Europës, në Perëndim dhe në Lindje, në Paris, në Beograd, në Shkup, e stacioni i radhës, pas Italisë, pritet të jetë Gjermania.

Po çfarë ka të veçantë ky roman? Thuajse gjithçka. Nuk ka hero rreth të cilit sillen ngjarjet, ka dëshmitar; nuk ka strukturë lineare, shkaktasojë, ka një mozaik ndodhish. Këtu personazhet, persona realë, sikur druajnë të dalin në rrugën kryesore, edhe ngaqë nuk kanë një objektiv për të realizuar; sillen më shumë në mjediset e brendshme të shtëpive, çardakëve e hajateve të Shkodrës së vjetër, oborreve, kapërcejnë mure, ngjiten mbi çati, e mësyjnë qiellin, si e vetmja rrugë e mundshme për t'u lidhur me botën. Autori nuk ka ndër mend të përcjellë racionalen te lexuesi, por të nxisë, të aktivizojë një mendim anësor, që çon drejt totalitetit.

Përkthimi i një libri si ky ose të bën bashkautor, ose është mirë t'i rri larg. Ndjesi e këndshme ta çosh një tekst kaq të ngrohtë në pelenat e një gjuhe tjetër, si një foshnjë.

Ky botim vjen pas atyre në Paris, "Chacun s'affole a sa maniere", përkthyer nga Ardian Marashi dhe botuar nga shtëpia botuese "Meet"; Beograd, "Svako poludi na svoj nacin", përkthyer nga Danillo Brajovic dhe botuar nga shtëpia botuese "Clio"; Shkup, "Seko poluduva na svoj nacin", përkthyer nga Jordana Shemko dhe botuar nga shtëpia botuese "Ars Lamina". Së shpejti do të kemi edhe botimin në gjermanisht.



Elemente të mësimi të besimit katolik dhe të leksikut të krishterë në shqipërimet e Atë Benedikt Demës O.F.M.

PROFILI PREJ SHQIPËRUESI I ATË BENEDIKT DEMËS

Nga Evalda Paci

Figura dhe emri i Atë Benedikt Demës O.F.M. lidhen pazgjidhshmërisht me kontribute që priren nga historia e shtypit françeskan, leksikografia shqipe, por edhe nga historiku i botimeve mbi mësimin e parimeve themelore të besimit të krishterë dhe praktikës liturgjike në gjuhën tonë. Perspektiva e mësimi të fesë dhe të besimit katolik në shkollat shqiptare në gjysmën e parë të shekullit të kaluar konkretizohet, ndër të tjera, në një botim disavëllimësh për përpilimin dhe shqipërimin e të cilit u angazhua në veçanti Atë Benedikt Dema.

Mësimi i përgjithët i besimit (Apologjetika) që botohet në Shkodër nga Shtypshkroja "A. Gjergj Fishta" në vitin 1943, mbështetet në një model të shkruar në gjuhë të huaj e të hartuar prej dr. A. König, docent i Universitetit të Breslaut.

Ai paraqitet në përmasat e një trajtese mjaft të gjerë e serioze, me synime të qarta nga përafrimi me përmbajtjen e Biblës, me kulturat e hershme jo domosdoshmërisht i.e., me antikitetin, por edhe me historinë e religjioneve. Veçanërisht, referimi ndaj Besëlidhjes së Vjetër përkon plotësisht me një prirje të qartë ndaj zbrërthimit të teksteve të saj në një dritë që sqaron më së miri elemente të Besëlidhjes së Re, sidomos pjesëve që lidhen drejtpërdrejt me shfaqjen konkrete të Mesisë në Ungjijtë. Në këtë pikëpamje nënvizohet qartë qëllimi teozofik dhe teologjik i të shkruarit të kësaj veprë dhe caktimit të saj për një auditor liceal e shkollor.

Puna e shqipëruesit Dema ofron një panoramë

të gjerë hulumtimi sa i takon besnikërisë së sjelljes së mjaft elementeve leksikore e konceptuale në këtë fushë, por edhe përrurimit të mjeteve të gjuhës sonë në realizimin e një përshtatjeje aspak të thjeshtë, aq më tepër nëse destinatari konkret do të jetë student i liceut të naltë klasik e real.

Pa dyshim, kurrikulat shkollore të atëhershme shfaqen të pasuruara në pikëpamje përmbajtësore mjaft të arsyetuara nëse u referohemi edhe botimeve të tjera, përfshirë këtu shqipërime gramatikash latine (Sintaksa dhe vëllime ushtrimesh të plota); histori qytetërimi të hershëm greko-romak, një pjesë e mirë e të cilave gjithashtu kanë parë dritën e shtypit në tipografinë Atë Gjergj Fishta. Mund të vërejmë në këto vëllime kaq të rëndësishme gërshetimin e dimensioneve që mëtojnë nga didaktika e metodologjia, rikthimin e vëmendjes nga disiplina themelore, si historia e antikitetit, filozofia antike e ajo mesjetare, shkencat e natyrës që qenë objekt vëmendjeje edhe në veprat e mesjetës së vonë dhe që e bëjnë mjaft interesante dhe objekt qasjesh të ndryshme veprën e shqipëruar nga Atë Benedikt Dema O.F.M.

Historia e Kishës së Romës, në veçanti periudha e problematika e Koncilit tridentin, gjejnë pasqyrim e shpjegim të zgjeruar në vise të veçanta të këtij shqipërimi, që ka të bëjë me mësimin e besimit katolik, për të vijuar më tej me vlerën që paraqesin përkthimet e Ungjijve në gjuhët përkatëse amtare, me një referim konkret edhe ndaj teksteve të disponueshme në atë kohë në gjuhën tonë e që lidhen me emra të spikatur të historisë së shqipërimin të tekstit biblik.

Bleni me titull *Mësimi i veçantë i besimit* (Shkodër, 1944), i treti në radhën e serisë përkatëse, por i dyti si pasues i botimit të vëllimit të parë të saj në gjuhën shqipe, përbën një zgjerim dhe zbrërthim të natyrshëm të mjaft koncepteve të cekura në vëllimin e parë të sipërcituar.

Duket ky i fundit më i thjeshtuar në pikëpamje të trajtimit të nënndarjeve tematike që kanë të bëjnë me vetë besimin katolik, por edhe në këtë pjesë të veprës kujdesi ndaj terminologjisë përkatëse dhe përfshirja e argumenteve sa filozofike aq edhe teologjike përbëjnë prirje të qarta e konsekuente në shtjellimin e përmbajtjes së saj.

Në paragrafë të caktuar të këtij vëllimi vihet re qartë se përmbajtja nuk shkëputet prej një misticiteti që buron nga vetë shpjegimet që kërkojnë, pa dyshim, referime etimologjike dhe historike, por nga ana tjetër kjo përmbajtje shfaqet më konkrete dhe më e lehtë për t'u ndjekur në pikëpamje të shkallës së vështirësisë së brendësimi të tekstit.

Është e mundur, pa dyshim, të gjurmohet përdorime që kujtojnë autorë paraardhës që ndërmorën sprova të shqipërimin të teksteve të caktuara nën synimin që të ishin funksionale në raste shërbesash liturgjike, por edhe të vëmë në dukje modele formimi dhe ndërtime që marrin domethënie pikërisht nën veshjen

që i jep në këtë vepër shqipëruesi ynë, Atë Benedikt Dema.


Pavarësisht natyrës së veprave që Atë Benedikt Dema ndërmerr të shqipërojë në këto vite, gjithsecila bëhet pasqyrë e një formimi specifik dhe të admirueshëm në fushë të terminologjisë së liturgjisë, por edhe e reflektimit të përdorimit të një sërë modelesh formimi që cekin e përfshijnë disa kategori semantike, njëkohësisht edhe klasa të caktuara fjalësh. Në çdo vështrim që synon të nënvizojë kontributet e Atë Benedikt Demës në këtë lamije hulumtimi e pune këmbëngulëse, duhet theksuar me bindje se ky formim pasqyrohet edhe në ruajtjen e natyrës së trajtesës dhe në përshtatjen me një nomenklaturë që bën të mundur të jetë edhe më e zgjeruar fusha e emërtimit të nocioneve të caktuara.

Përdorime të caktuara bëjnë të nënvizosh bindjen se ndërtimet që në njëfarë mënyre u promovuan në veprat e letërsisë së vjetër shqipe, gjejnë një vijimësi të natyrshme në këto shqipërime. Kësisoj, të tilla botime, që bëhen edhe më të vjera me kalimin e viteve dhe janë përfaqësuese të sprovave për të plotësuar një panoramë të shqipërimin të punimeve në fushë të liturgjisë, por edhe pjesëve nga Ungjijtë apo patrologjia kryesisht latine që domosdoshmërisht përfshihen si elemente tekstore ilustruese në përmbajtjen e tyre, bëhen dëshmi e eficientës së zgjidhjeve të ofruara kohë më parë nga autorë paraardhës.

Nga një vëzhgim i hollësishëm i përftesave që bëhen objekt përdorimi në këto shqipërime, mund të nënvizohet prirja për terma sa më të përshtatur, ndër të cilët veçojmë *hyjnderim*, *parafolje*, *parathanje*, *parandjesi*, *parakënë*, por edhe shpjegime në shqipe që u pranëvihen termave dogmatikë në gjuhën latine.

Në rastet e shqyrtuara, Atë Benedikt Demës mund t'i atribuojmë pa ngurrim merita autorësie për vetë zgjidhjet jo thjesht leksikore që ofron ndaj një regesti terminologjik aspak të thjeshtë për çdo gjuhë, jo vetëm për shqipen. Në pikëpamje të modeleve të formimit, gjejmë me vend të veçojmë një sërë ndërtimesh që në kuptimin kategorial, por edhe fjalëformues, janë emërzime trajtash me origjinë ndajfoljore, emra veprimi, emra prejfoljorë të tipit *kena* e *gjëja*, por gjithashtu edhe fjalë *plaka* (të moçme) që plotësojnë hijshëm tekstet e këtyre shqipërimeve. Nuk lëmë dot pa përmendur pranëvënien përdorimesh, si *Këna e njisija* e *Hyjit*; *Natyrë e vetit* e *Hyjit*; *Njinija* e *Trinija* e *Hyjit*, të rëndësishme si në pikëpamje të vendit që zënë në përbërje të veprës së Artur König, ashtu edhe po aq të rëndësishme në pikëpamje të nëntekstit që realizohet nëpërmjet këtyre përdorimeve të pranëvëna.

Dema ka njohur dhe ka vënë në përdorim, pa dyshim, shkrimet e autorëve të letërsisë së vjetër shqipe, por siç duket edhe nga shënimet me të cilat plotëson brendinë e shqipërimin të mësimi të besimit katolik në liceun e naltë, ai ka njohur dhe konsultuar shqipërimet e varianteve ungjillore të Atë Xanonit e të Dom Lekë Bitrojt, pse jo edhe të Kristoforidhit, të cilat edhe i citon duke i diferencuar konkretisht në disa pasazhe të punimeve në fjalë. Plotësimi i nomenklaturës së konceptit të Krijuesit, por dhe të krijimit në dritën e historisë së fesë e të filozofisë me plot attribute e ndajshime, duhen konsideruar vlerë e aftësisë së shqipëruesit për të bërë tekstin sa më të afrueshëm dhe të qartë e të saktë me lexuesin e tij. Ndërtime si *fe*, *besim* e *religjion* gjinden në paragrafë të caktuar të këtyre shqipërimeve, duke qenë fjalë kyçe që shënojnë pika të rëndësishme në të cilat është ndalur si autori, ashtu edhe vetë shqipëruesi si përshtatës i tekstit në fjalë: *Besimi i ynë do të jët i fortë e i qindrueshëm, d.m.th. na nuk do të dyshojm vullëndetisht per kurrnji të vërtetë fetare e do të jemi gati, qi m'a parë të bierrim gjithshkaken, t'apim edhe jeten vetë, se t'i biejm mobit fës. (Martyrët shëjten.) Besimi i ynë do të jët i plotë d.m.th. na do të besojm pa perjashtim të gjitha të vërtetat e zbëlueme; do të jët edhe i gjall, d.m.th. do të jetojm si na mëson besimi, prandej do t'i largohemi së keqes e do të bajm*





Klerikët që dhanë mësim në shkollat shqipe, mes tyre dhe Atë Benedikt Dema

vepra të mira. Nji kesi besimi është vepra më e randsishmja e nderimit të Zotit e nji dhantë e bukur, qi mendja e njerit bân para gjithdijes e vertetësis së Hyjit.

Duhet vënë në dukje se veçanërisht në përbërje të këtyre vëllimeve të konsultuara të *Mësimi të besimit katolik* gjinden jo pak fragmente nga Ungjijtë dhe nga Besëlidhja e Vjetër. Duke qenë destinuar të jenë elemente ilustruese në përmbajtje të një punimi shpjegues e shtjellues të mjaft prirjeve që kanë të bëjnë me njerëzoren dhe përballjen e saj me hyjnore, mistikën dhe thelbin e besimit të Zotit, reflektimin e besimit në jetën e individit, këto elemente tekstore në më të shumtën e rasteve paraqiten koncize dhe jo fort të gjata.

Është po aq e qartë se në botimet që Atë Benedikt Dema, asokohe profesor në Lyceun "Illyricum" të Shkodrës, përzgjedh të shqipërojë dhe t'ia ofrojë një auditori kryesisht intelektual dhe që zotëron një kulturë fetare, gjurmohen natyrshëm pasazhe dhe elemente introductive që të kujtojnë si ligjëratat e plota në pikëpamje tematike në veprën e Bogdanit, ashtu edhe pjesë të tjera nga doracakët kateketikë që në gjuhën shqipe panë dritën e botimit dhe të ribotimit, duke na ofruar edhe variante të njëpasnjëshme të *Besojmës*, gjithashtu edhe të lutjeve të tjera themelore në liturgjinë e përditshme. Veprat që ndërmoi të shqipëronte Atë Benedikt Dema O.F.M. mbartin edhe përmasën didaktike që ka të bëjë me një lloj brendësimi përmbajtësor të vetë Biblës, por jo më pak atë ezegjetike dhe pedagogjike. Ngërthimi i natyrshëm, por edhe i arsyetuar, i tyre vihet re në secilën prej këtyre sprovave që mbartin përkujdesjen e thelluar prej shqipëruesi nga ana e tij.

Veçanërisht në blenin e dytë për nga radha e botimit të kësaj kolane vihet re nënvizimi i një synimi: shkrirja e qartë e dimensionit teologjik me atë doktrinar e kateketik. Nënvizohen të vërtetat e fesë, por edhe të mësuarit e nocioneve dogmatike në proces të katekezës apo praktikës së liturgjisë, sidomos kur përshkruhen detaje të një kulture specifike që ka të bëjë me *Mëshën shëjte* dhe çdo hollësi tjetër që lidhet me zhvillimin e saj, detaje këto që kanë të bëjnë edhe me meshtarin, edhe me besimtarin. Sakraliteti i këtyre elementeve plotësohet nga vetë regjistri gjuhësor i përdorur, që dëshmon njohuritë e thella të shqipëruetit në një sërë fushash, nga të cilat nuk lëmë pa veçuar atë të historisë së kulturave fetare e vijimësisë së tyre të pasqyruar në besimin katolik. Pa dyshim që të tilla shqipërime janë njëkohësisht një burim i rëndësishëm dokumentar për studiues të dialektologjisë shqipe e në veçanti të asaj historike. Një dimension i tillë vihet re në veçanti në botimin *Jeta e krishtenë*, i cili është konceptuar të shërbejë si një *librec këshillësh e mësimesh sidomos për civila intelektualë*.

Jeta e krishtenë (librec këshillësh e mësimesh sidomos për civila intelektualë), në dukje një libërth modest në pikëpamje vëllimi, por mjaft interesant në pikëpamje të gjurmimit përmbajtësor, përbën një shtysë të goditur për të përmbushur qasje me variante paraardhëse doktrinash a doracakësh kateketikë që edhe pse më të përmbledhur falë faktit që kanë pasur objektivin e të përmbajturit në përmasa compendiumesh sintetike, përmbajnë në thelb një nomenklaturë të tërë elementesh e emërtimeve që gjinden gjithashtu edhe në variantin e shqyrtuar të Benedikt Demës. Ky botim i fundit jep shkas gjithashtu për hulumtuar ndaj një prirjeje po aq të veçantë në përkujdesjen ndaj tekstit nga ana e Benedikt Demës, duke qenë se i ofrohet mundësia të introdukojë variante lutjesh themelore të ngulitura në gegnishten e asaj kohe.

Të shkruarit në një gegnishte konsekuente dhe skrupuloziteti ndaj një regesti terminologjik kompleks që mbart qartë përpjekjen për të emërtuar saktë e duhur çdo nocion të rëndësishëm të fushës së liturgjisë dhe teologjisë, mbetet një prej tipareve qenësore të këtyre shqipërimeve. Elemente të rëndësishme të një jete mendore që ka të bëjë drejtpërdrejt me praktikën religjioze në vise të caktuara të Shqipërisë (u referohemi dhe përdorimeve si *kryqa*, *rruzare*, *medaja*, *kemi*, *shkandull*), mbijetojnë edhe sot e kësaj dite duke shërbyer edhe si relikte të një spektri më të hershëm, por dhe të gjerë, kulturor e mendor.

Vetë veprat që u përpunuan nga Atë Benedikt Dema O.F.M. përfaqësojnë në vetvete modele të veçanta në pikëpamje të ndërthurjes së disa elementeve përmbajtësore që evokojnë, pa dyshim, edhe doracakë kateketikë apo liturgjiarë me përmbajtje dhe lutjesh themelore në fushë të praktikës fetare, dhe vepra me prirje nga ezegjeza dhe didaktika biblike. Qasja e tyre me të tjera vepra analoge që disponojmë falë një tradite të pasur shkrimore të promovuar nga Dom Lekë Bitroj, Atë Jak Junk S.I., Vinçens Prennushi, Donat Kurti, Justin Rrota e prelatë të tjerë bën të mundur shprehjen e mendimit se një periudhë e tillë kohore ka shënuar me anë kontributesh konkrete një tjetër shtysë në ecurinë e shqipërimit dhe përshtatjes së veprave fetare në traditën e besimit katolik. Ato meritojnë vëmendje në pikëpamje të shkallës së lëvrimin të shqipes dhe kontributit në drejtim të promovimit të pasurisë kryesisht leksikore të shqipes. Profili prej shqipërueti i Atë Benedikt Demës O.F.M. shënohet ndjeshëm nga këto kontribute të realizuara në gjysmën e parë të viteve '40 të shekullit të kaluar e që kanë të bëjnë me mësimin e fesë e të besimit, mësimin e moralit dhe historinë e Kishës e të krishterimit. Konkretësia e tyre bën që ato të radhiten si ndihmesa themelore në fushë të shqipërimit dhe të tekstit liturgjik dhe atij biblik, duke qenë i përfshirë ky i fundit në çdonjërin prej veprave që u ndërmorën në këtë trajtesë.

PËRKTHIMI

YLLJET ALIÇKA


"Valsi i lumturisë" botohet në gjuhën frënge

Botohet në Francë romani "Valsi i lumturisë" i shkrimtarit Ylljet Aliçka, nga shtëpia botuese "L'esprit du temps", përkthyer nga Michel Aubry, me parathënie të Ismail Kadaresë.

Në parathënien e këtij botimi në gjuhën frënge shkrimtari Ismail Kadare shkruan, ndër të tjera: "Një roman i shkruar me art dhe dinjitet." Ndërsa botuesi francez shkruan për këtë libër: "Një rrëfim jashtëzakonisht ironik dhe absurd, i frymëzuar nga një histori e rrallë, ku zbulohen dy botë, gjë e rrallë kjo për romanin tradicional. Është kjo qasje që e bën letërsinë e Aliçkës origjinale dhe njerëzore." Ndërsa pas botimit të këtij romani në Itali, gazeta "Corriere della sera" ka shkruar: "Qesh hidhur tek lexon këtë roman, e megjithatë qesh."

Ndërsa ish-ambasadori italian në Shqipëri, Mario Bova, shkruan në revistën *L'indice*: "Si vepër letrare, "Il sogno italiano" (*Valsi i lumturisë*) i kapërcen fuqishëm kufijtë e një hapësire kombëtare e lokale, për të arritur fuqinë e një reflektimi mbareuropian, për tragjedinë e tmerrshme të fenomeneve të emigracionit drejt kontinentit."

Romani "Valsi i lumturisë", i botuar nga shtëpia botuese "Toena", mbështetet në një ngjarje të vërtetë. Në dhjetor të 1985-s gjashtë anëtarët e familjes Popa hynë ilegalisht në ambasadën italiane. Rasti i tyre bëhet çështje ndërkombëtare për Shqipërinë e vogël e të izoluar. Familja Popa, një familje e thjeshtë nga Durrësi, hyn tinëzisht (duke u hequr si turistë) në ambasadën italiane dhe aty kërkon menjëherë strehim politik. Shteti totalitar shqiptar pëson një tronditje të madhe nga ky gjest. I quan shtetasit e vet "kriminelë". Kush kishte guxuar ta bënte më parë një gjë të tillë, ishte pushkatuar. Ngjarja që erdhi nga këta njerëz të thjeshtë, mori përmasa të paparashikueshme ndërkombëtare. Gjashtë anëtarët e familjes Popa, nga frika e dënimit, deklaruan se do të vetëvriteshin nëse ambasadori italian i dorëzonte në duart e sigurimit të shtetit shqiptar. Ata u mbrojtën për rreth 5 vjet në ambasadën italiane, veprim që u bë shkak për tensionimin e marrëdhënieve diplomatike mes dy vendeve, por edhe shkak për kthimin e vëmendjes së ndërkombëtarëve drejt Shqipërisë. Ambasada italiane rrethohet me mbi 600 mijë policë. Përtej brigjeve, televizioni italian transmetonte ngjarjen reale nga Tirana.



Aktorja e njohur nga Kosova, Ilire Vinca, prezente në Tiranë në një projekt teator, tashmë të përfunduar, luajti për disa javë rolin e nënës në shfaqjen “Natën, má”, me regji të Ema Andreas. Një nga aktoret që ka bërë histori, duke numëruar 35 role në teatër dhe 35 në kinematografi. Në intervistën e mëposhtme ajo tregon eksperiencën e saj si aktore në skenë...

ILIRE VINCA NË TEATËR, KOMUNIKIMI ME PUBLIKUN ËSHTË GJITHMONË I FRESKËT, KURRË NJËSOJ

Intervistoi: Anila Dedaj

Drama “Natën, má” e Marsha Norman, fituese e çmimit “Pulitzer”, ka qenë ndër më tronditëset për gati dy sezone në kryeqytet, Tiranë. Nën regjinë e Ema Andreas, dy aktore – Ilire Vinca nga Kosova në rolin e nënës dhe Egla Ceno në skenë si e bija, – kanë përshkuar tensionin psikologjik që shkakton depresioni dhe pas tij, ideja e vetëvrasjes. Nëna përballë së bijës nuk mundën të ndryshojnë fatin e njëra-tjetrës, përpos të realizojnë një tablo të hapur, mbi ç’ndodh brenda qenies në këto pëshpërime vdekjeprurëse të fjalës. Interpretim me forcë e thellësi psikologjike prej të dyja aktoreve. Por për publikun shqiptar është e rrallë të shihet profili i një aktoreje me fibra artistike aq të kuruara sa tek Ilire Vinca. Me përvojën e skenës së teatrit, por edhe në kinema, Vinca sjell këtë rrëfim:

Zonja Vinca, 25 vjet karrierë në kinema dhe në teatër. Nëse kthehemi në retrospektivë, si lindi dëshira për t’u marrë me aktrim?

Një histori që zanafillën e ka shumë të herët dhe që ndoshta tek unë ka lindur në atë fazë kur njeriu ende nuk mund të vetëdijesohet për të ardhmen e tij, para se të artikuloja mendimet. Diçka e tillë ndoshta ka ndodhur, pasi unë jam rritur mes poezisë, artit e këngës, falë edhe babait tim, i cili është poet dhe studiues i letërsisë. Nuk mund ta mohoj se kur erdhi momenti që unë duhet të vendosja, të zgjidhja profesionin, kam pasur shumë dilema, sepse isha e tërhequr nga fusha të tjera të artit krahas aktrimit, si muzika dhe piktura. Mirëpo ndonjëherë në jetë vijnë disa momente që, në njëfarë mënyre, të përcaktojnë fatin. Për mua ndodhi kur duhet të bëja regjistrimin, për kohëzgjatë u hap dega e Arteve Dramatike në Prishtinë (1989). Mirëpo ndodhi që u pajisa me dy indekse: nga njëra anë, nëna donte të më siguronte një profesion më të sigurt, si mjekësia, nga ana tjetër, babai nuk hoqi asnjëherë dorë dhe gjithmonë e përforcoi edhe më shumë dëshirën time për t’u marrë me art. Kështu i ndoqa të dyja deri në vitin e tretë, deri në kohën kur shkollat shqipe u mbyllën (1990-1991) dhe ne dolëm nga objektet shkollore. Pra, gjeografikisht, u bë e pamundur që t’i ndiqja të dyja degët, por nuk ishte vetëm kjo... Unë ndodhesha në një pikë që isha pjekur mjaftueshëm sa për të vendosur përfundimisht drejtimin që doja të merrja. Pra, duhet të jepja maksimumin tim në një prej tyre dhe profesioni, në njëfarë mënyre, të më përmbushte. Kështu zgjodha artin! Që një zgjedhje e bërë me shumë lehtësi. Nuk pata asnjë dilemë, e dija se duhet të isha një aktore më shumë dhe jo një mjekë më shumë. Më dukej sikur mjekë kishte mjaftueshëm.

Karakterizoheni gjithashtu nga mirënjohja, edhe kur flisni për pedagogun tuaj Faruk Begollin...

Të thuash se Begolli ishte një profesor i mirë, është pak. Ishte i jashtëzakonshëm. Nuk është kujdesur vetëm për edukimin tonë përmes leksioneve të aktrimit, por ka ndikuar te secili prej nesh, për sa i përket orientimit tonë si qenie njerëzore. Gjithmonë duke mbjellë dashuri dhe respekt ndaj njëri-tjetrit, duke kultivuar disiplinën e punës. Përpiqej që të evidentonte pikat tona të forta si aktorë, karakteristikat specifike. Sepse, edhe pse ne mund të jemi të gjithë aktorë, asnjë nuk del nga shkolla i njëjtë si tjetri. Ai ka bërë të mundur që çdokush nga ne të dalë nga shkolla e të bëjë atë që di të bëjë më së miri. Ishte shumë i afërt dhe njëherazi, shumë i rreptë. Një kombinim i përsosur! Kur ne festonim deri në orët e vona ndonjë premierë, e dinim se duhet të ishim fiks në kohë në prova të nesërmen, pasi nuk kishte asnjë tolerancë.

Keni prekur suksese si në teatër ashtu edhe në kinematografi. Si e ruani balancën mes ekranit dhe kontaktit të drejtpërdrejtë me publikun? Si ka ndryshuar Ilirja gjatë këtyre viteve, duke bërë që regjisorët ta përzgjedhin si protagonisten e shfaqjeve/ filmave të tyre?

Ka edhe të tjerë kolegë që janë aktorë si në teatër ashtu edhe në kinematografi. Mendoj se kjo balancë nuk është shumë e vështirë për t’u mbajtur, mjafton të krijosh një shenjë dhe të kuptosh si duhet të luash në

skenë e si në shesh të xhirimit. Ndoshta të tjerët mund të flasin më mirë për atë që shohin tek unë. Ajo që unë mund të them me siguri, është se e dua punën që bëj dhe është pikërisht ky starti i gjithçkaje.

Në momentin që ju pranoni një rol, si futeni në petkat e personazhit?

Fillimisht, është leximi i parë i pjesës, që mandej të perceptoj përshtypjet e mia të para dhe t’i shkruaj, pasi janë shumë të rëndësishme. Mandej duhet të jesh shumë i durueshëm për të zbuluar çdo shtresë të personazhit dhe kjo duhet bërë pa rënë në grackën e demonstrimit, por duke mbetur te përjetimi. Pra, duhet të veshësh të gjitha karakteristikat që personazhi ka, jo vetëm një aspekt. Të arrish një dimension brenda kontekstit, që t’i afrohet sa më shumë spektatorit me të gjitha dilemat, pyetjet që mund t’i zgjohen pas asaj shfaqjeje. Do të ishte mirë që pas atij roli, ndonjëherë të ketë edhe debate në publik, që ishte apo nuk ishte kështu. Pra, duhet të sjellësh diçka që t’i ngacmojë dhe t’u afrohet sa më shumë.

Ndër rolet që keni interpretuar, a ka ndonjë prej tyre ku ndoshta e keni gjetur më shumë veten?

Secili prej roleve të mia ka diçka të ngjashme me mua, sepse vjen prej meje, buron nga unë. Çdokush nga ne ka një botë të tijën emocionale, një mënyrë specifike se si i qaset punës, se si e shohim një personazh. Jam e bindur se rolet e mia mund t’i luaj shumë bukur edhe një tjetër aktore. Nuk është se e kam zbuluar unë Telmen dhe asnjë Telmë tjetër nuk do të funksiononte. Ka shumë Telma në botë, po aq sa ka edhe aktore, dhe mendoj se secila prej tyre do ta zbulonte më të bukurën nga vetja brenda një roli. Kështu që mendoj se rolet e mia kanë pak Ilire, por njëherazi rolet janë edhe një vulë, një gjurmë tek Ilirja. Këtë e shikoj po ashtu si një kombinim shumë të bukur.

Dhatë në skenën e teatrit në Tiranë “Natën, Má”, një shfaqje e fortë dramatike, ku ju sillni emocione tronditëse të një nëne. Si e keni përjetuar këtë rol si aktore, por edhe në një aspekt më personal, si nënë e tri vajzave?

Është një rol, një proces shumë kompleks. Kjo, pikësepari falë tekstit fantastik, pastaj edhe për bashkëpunimin që arrihet. E ndaj fatin e nënës dhe së bijës me një aktore si Egla Ceno, në një mënyrë shumë të bukur, që përcjell ndjeshmëri të lartë. Mandej Ema është e jashtëzakonshme dhe i kushton vëmendje maksimale çdo nuance që ne duhet të kërkojmë dhe të nxjerrim nga vetja. Kjo pjesë më ka bërë që jo vetëm si nënë e tri vajzave të kthej sytë nga vetja, ta vëzhgoj



veten, duke pyetur: A ka pasur një moment që unë kam qenë kështu, që kam reaguar në këtë mënyrë?! Pastaj jam kthyer edhe më në kohë, si bija e një nëne, duke pyetur përsëri veten: A kam qenë kështu ndonjëherë? Si jam sjellë me “nanën” e si ajo me mua. Kështu pyetje pas pyetjeje reflektimi është shumë i bukur, kaq personal dhe profesional në të njëjtën kohë. I gjithë ky proces i ka dhënë një dimension më shumë shfaqjes, sepse është një përjetim i ndjerë, i bukur. Është i tillë ndoshta edhe sepse nuk ka përgjigje. Për aq sa zgjat shfaqja, ne prekim, gërmojmë, përrjetojmë, zbulojmë, por nuk arrijmë të zgjidhim asgjë. Pra, është një proces, një vorbull nëpër të cilën kalojnë të gjithë njerëzit.

Është një komunikim, siç e thatë edhe ju, shumë kompleks nënë e bijë ai i Telmës me Xhesin. Sa e vështirë është të arrihet kjo urë dialogimi mes palëve në jetën reale, të kuptohesh, të kuptosh dhe të bësh një zgjedhje?

Është e vërtetë, në këtë shfaqje shkojmë drejt komunikimit me një vështirësi të madhe. Diçka që unë nuk e has gjithmonë me vajzat. Pra, si prind, duke dashur të bësh më të mirën, nuk e di se cilën rrugë të zgjedhësh. Nëse duhet të thuash “Po”, apo “Jo”. Mandej janë dilemat se deri ku duhet ta nxitësh. Dilema të mëdha e komplekse që vijnë me shumë ngjyrë. Në shfaqje ndodh komunikimi nën një presion shumë të madh. Ndërsa unë me vajzat kemi një marrëdhënie shumë të afërt dhe dialogojmë lehtë. Kemi punuar shumë të dyja palët në këtë aspekt, i jam dedikuar shumë kësaj pjese.

Ju jeni gjithashtu pedagoge për artet në Prishtinë. Si e shikoni ecurinë e aktorëve të rinj? A ka mes tyre talente?

Mendoj se po rritet një brez i ri artistësh shumë të talentuar. Duke punuar si pedagoge e vërej këtë, mirëpo fati i keq i tyre është se Kosova ka mbetur ende e izoluar. Është diçka të cilën ne e përjetojmë, një padrejtësi shumë e madhe që na është bërë. Një izolim i tillë nuk ka të bëjë vetëm me faktin se dikush duhet të ngjitet në avion e të shkojë në një tjetër vend, por ka të bëjë me dhunën e peshën psikologjike që njeriu e pëson kur është i izoluar dhe nuk ka mundësi për të bërë një zgjedhje të lirë. Ndikon shumë, ndikon keq nga ana psikologjike. Pra, tek të rinjtë nga ky fakt has një lloj shuarjeje të shpresës, mbyllje të vizionit. Diçka e tillë bën që motivimi për punën të bjerë, sepse ata mendojnë se ajo që bëjnë qëndron brenda një kornize, vetëm brendapërbrenda. Në këtë mënyrë, fillojnë kompromiset me veten, çka bën që ndonjëherë të mos hapen disa dyer të cilat, edhe pse mund të mos jemi të vetëdijshëm, janë aty për ne. Izolimi ndihet, është një peshë që e ndiej si pedagoge dhe profesioniste. Shpresoj që diçka e tillë të ndryshojë shumë shpejt, pasi do të ndryshonte mentalitetin dhe qasjen ndaj punës së tyre, sepse fakti që puna mbetet vetëm brenda kufijve, shpesh demoralizon. Zbeh dëshirën, ndjenjën e vetëvlerësimit të ballafaqimit jashtë kufijve. Izolimi mund të bëhet konsumues.

Dy vjet më parë u nominuat nga League of Professional Theatre Women në New York si një



nga 20 aktoret më të mira në botë, ndërkohë që jeni vlerësuar me çmime të tjera të rëndësishme. Si i përjetoni të tilla suksese?

Një shprehje e mençur thotë: “Lajkat, çmimet, janë të bukura, duhet t’i shijosh, por të mos i mbash afër. Duhet lënë anash.” Pra, sado që të na gëzojnë, i konsideroj më tepër si një dëshmi se puna duhet të vazhdojë më me seriozitet, përkushtim dhe dashuri. Ndonjëherë më gëzojnë më shumë fjalët e njerëzve, mbështetja e publikut, energjia që ai më jep duke më shpërblyer punën që çdo ditë kam bërë në kinema apo teatër.

Cilat janë emocionet që përjetoni pas një shfaqjeje? A ka ndonjë moment që mund të veçonit?

Ka shumë... Çdo shfaqje, çdo publik, çdo individ që vjen në sallë, më sjell diçka me vete. Përjetimet e publikut janë të veçanta, asnjë natë nuk është njësoj. Mendoj se është kjo që e bën të bukur teatrin, që një person, aktor, i jep jetë një personazhi, duke krijuar njëherazi një audiencë të re. Kontakti me publikun është gjithmonë një komunikim i freskët që ndodh aty për aty dhe që nuk përsëritet asnjëherë njësoj. E vërtetë që i jap shumë publikut, por edhe marr shumë prej tyre.

Dikur patët mundësinë për t’u bërë mjeke, duke iu dedikuar këtij profesioni për tre vjet. Nëse do të ktheheshit pas në kohë, do të rizgjidhnit përsëri aktrimin?

Mendoj se po! Kam shumë imagjinatë dhe ndonjëherë fantazoj: po sikur të isha bërë kështu? Po sikur të kishte ndodhur kështu? Ne kemi një shans të vetëm dhe jetën nuk mund ta paramendojmë, as të kthehemi pas e të shohim se si do të kishte qenë, por unë jam shumë e kënaqur për zgjedhjen që kam bërë. Siç e thash më sipër, jap shumë nga vetja, por njëherazi marr po aq nga të tjerët. Diçka e tillë më bën një njeri shumë të lumtur!

PROMOVIMI

Studiuesit e Ballkanit me librin “Iliria e Jugut dhe Epiri në antikitet”

Instituti i Arkeologjisë pranë Akademisë së Studi-
meve Albanologjike, në bashkëpunim me Univer-
sitetin Lyon 2 Lumière dhe ambasadën e Francës
në Tiranë, prezantuan botimin e akteve të konfer-
encës së gjashtë ndërkombëtare “Iliria e Jugut dhe
Epiri në antikitet”.

“Iliria e Jugut dhe Epiri në antikitet” është
simpoziumi i gjashtë që organizohet që prej
vitit 1984. I pari është mbajtur në Clermont-
Ferrand (Francë) me iniciativën e P. Cabanes-it, i
fundit në Grenoble (Francë), në tetor 2008. Çdo
gjashtë vjet kjo veprimtari e rëndësishme bën
bashkë gjithë komunitetin shkencor që punon në
Ballkan, me kërkime që shtrihen nga periudha
para dhe protohistorike, deri në mesjetën e
hershme bizantine. “Iliria e Jugut dhe Epiri në
antikitet” është simpoziumi i vetëm në këtë fushë
dhe bashkon studiues nga vendet e Ballkanit,
studiues europianë dhe amerikanë që punojnë në
projektet ndërkombëtare. Në botimin e akteve të
simpoziumit të gjashtë janë përfaqësuar 12 shtete
me mbi 130 studiues. Për herë të parë në traditën
e kësaj veprimtarie shkencore ajo u zhvillua në
një vend ballkanik. Ndërsa paraqiten rreth 1200
faqe që sjellin të gjitha të rejtat, nga periudha
prehistorike, antike edhe ajo mesjetare. “Jam shumë
i lumtur që vij në këtë ceremoni të thjeshtë që sjell
përfundimin e punës sonë. Kjo punë ka nisur prej
disa vjetësh, prandaj ky libër është si lindja e një
fëmije. Është konferenca e gjashtë “Iliria e Jugut
dhe Epiri në antikitet” që për herë të parë bëhet në
Shqipëri. Është e vetmja konferencë ndërkombëtare
që përmbledh të gjitha vendet ballkanike. Kjo
konferencë është zhvilluar pesë herë në Francë.
Duhet që kjo eksperiencë të vazhdojë, prandaj
jam shumë i lumtur që u zhvillua në Ballkan, në
Shqipëri”, - shprehet profesor Jean Luc Lamboley,
editor i librit dhe përfaqësues i Universitetit Lyon
2 Lumiere në Francë. 35 kumtesa vijnë si kontribut
i arkeologëve shqiptarë, të cilët kanë bërë kërkime
gjatë viteve të fundit në të gjithë territorin shqiptar.
Por, për herë të parë pjesë e tij bëhen edhe studiuesit
nga Kosova. “Në fakt, në aktet e botuara të aktit të
gjashtë ka shumë risi brenda tij. Së pari, ky botim kap
një diapazon më të gjerë të periudhave prehistorike,
antike dhe asaj mesjetare. Nëse më parë, deri te
botimi i pestë, ka pasur më pak përfshirje, tani është
më i zgjeruar. Janë 35 kumtesa që vijnë si kontribut
i arkeologëve shqiptarë që punojnë në territorin
shqiptar. Në këtë botim vijnë disa problematika,
duke qenë se vetë Iliria e Jugut dhe Epiri, duke
u përfshirë në Ballkan dhe duke qenë edhe pjesë
e Mesdheut, ndërthur edhe me materiale që vijnë
nga kolegë nga Italia, Franca, por edhe nga Greqia,
kanë dhënë edhe të dhënat e fundit që lidhen me
territorin e tyre. Është një studim që është tepër i
thelluar dhe që lidhet edhe me provincën Dardane
dhe nga popullsia shqiptare në territorin e Kosovës.
Ky botim që tani është shumë i kërkuar nga shumë
biblioteka të ndryshme të Europës”, - thotë Luan
Përzhita, drejtor i Institutit të Arkeologjisë.



Viti 1986 shënon edhe takimin e parë të Kostandin Kavafit me lexuesin shqiptar. Atëherë u botua një *Antologji e poezisë greke*, përgatitur nga Pirro Misha. Në të u përfshinë 11 poezi të tij, 10 prej të cilave në përkthimin e Ismail Kadaresë dhe 1 në përkthimin e Llambro Rucit. Që atëherë interesi për K. Kavafin u rrit. Më 1997 u botuan dy përkthime të tjera të K. Kavafit, një nga shtëpia botuese “Onufri” në përkthimin e Luan Zykës dhe një nga shtëpia botuese “Albin” në përkthimin e Perikli Jorgonit e Rudolf Markut. Katër vjet më vonë, në vitin 2001, shtëpia botuese “Ombra GVG” botoi një përkthim tjetër të K. Kavafit, kryer nga Llambro Ruci. Në vitin 2010 dalin në dritë edhe dy përkthime të tjera: *Vepra poetike*, nga botimet “Pegi”, ku përfshihen 154 poezitë e miratuara të K. P. Kavafit, përkthyer nga Aristotel Spiro, si dhe *Poezi, shkrime kritike & estetike* nga Gent-Grafik, përkthyer nga Mariela Stefanllari. Pesë libra të Kavafit në një gjuhë nuk do të përbënin ndonjë çudi të madhe. Ka gjuhë si spanjishtja, në të cilën vepra e tij numëron 35 botime në përkthime të ndryshme. Në anglishte ka 35 botime e ribotime, në frëngjishte 19, në gjermanishte 17. Por, po të marrim parasysh praktikën e rëndomtë të përkthimeve nga letërsia e huaj në shqip, rasti i K. Kavafit përbën një përjashtim. Nuk ka asnjë autor tjetër që të jetë përkthyer kaq shumë, madje brenda një kohe të shkurtër.

Përkthimet e veprës së Kostandin Kavafit në gjuhën shqipe janë shënuar edhe nga karakteristika të kohës në të cilën kanë hyrë në këtë gjuhë, nga mënyra se si kanë hyrë, por edhe nga konceptet e përkthimit që janë zbatuar.

Siç u tha edhe më lart, më 1986 u botua nga shtëpia botuese “Naim Frashëri” një *Antologji e poezisë greke*. Në të jepej një panoramë e përgjithshme e poezisë greke, ku përfshiheshin edhe disa pjesë nga krijimtaria popullore. Në kushtet e censurës së fortë ky botim mund të interpretohet si një përpjekje për të njohur nga afër fqinjin e panjohur, një parim të cilin e kishte adoptuar udhëheqja komuniste e Shqipërisë së atëhershme. Botimi i antologjisë përbënte një ngjarje të shënuar në njohjen e poezisë greke në Shqipëri. Ishte edhe një komunikim midis krijuesve, ngaqë në përkthimin e autorëve të përzgjedhur morën pjesë shumë përkthyes dhe poetë shqiptarë. K. Kavafi, sigurisht, nuk mund të mungonte nga ajo antologji. Ishte hera e parë që ai vinte në shqip. Rruga që kishte përshkuar për të ardhur deri në Itakën shqiptare ishte e lodhshme. Megjithatë kaloi në duart e një mjeshtri të madh të fjalës, siç është Ismail Kadareja, iu desh të kalonte më parë nga brigjet poetike franceze apo ruse, meqenëse brigjet origjinale gjuhësore kavafiane ishin jo shumë të afërta për Kadarenë. Përvoja poetike e shkrimtarit të njohur shqiptar e ndihmoi që të kapërcente ato vështirësi të kuptueshme që lindin në raste të tilla. Është një përkthim i drejtuar nga lexuesi shqiptar, i cili nuk e ka të vështirë të ndiejë se një figurë poetike monumentale si K. Kavafi shoqërohet dhe prezantohet gjithashtu nga një penë e fuqishme e letrave shqipe me mënyrën dhe mjetet e Kadaresë. Por K. Kavafi, si një poet i mesazheve universale, nuk do të dilte fare i padëmtuar nga ardhja në letërsinë shqipe në një kohë të tillë censure. Duke qenë poeti i lirisë dhe i përvojës njëkohësisht, ai u ndesh me Lestrigonët dhe Ciklopët censurues. Dhe ndodhi ajo që nuk mund të imagjinohet në asnjë përkthim serioz letrar. Poezia kryesore e K. Kavafit, “Itaka”, del në gjuhën shqipe me një varg më shumë. Një varg i cili nuk ekziston në origjinal. Ja se si mbaron poezia:

*N’ e gjetsh të varfër nuk ka faj
Prej saj askurrë mos u zhgënj
I mençëm siç je bërë tashmë,
Besoj kupton se ç’janë “Itakat”
Besoj kupton se ç’është Atdheu (81).*

Vargu i fundit “Besoj kupton se ç’është Atdheu” nuk është i K. Kavafit. Ai është shtuar në Shqipëri. Kemi çdo arsye për të besuar se kjo gjë nuk është bërë nga I. Kadareja. Një poet i madh nuk mund të bënte diçka të tillë. Vargu i paqenë në origjinal u shtua nga redaktorët.

KRAHASIME TË PËRKTHIMEVE TË KOSTANDIN KAVAFIT NË GJUHËN SHQIPE

Nga Aristotel Spiro

(Le të kujtojmë këtu që “Antologjia” është përgatitur nga Pirro Misha, ndërsa recensentë ishin Pano Çuka dhe Fatos Arapi.) Mund ta shpjegojmë, por nuk mund ta shfaqojmë këtë sakrilegj letrar. Po ashtu te poezia tjetër e Kavafit, “Duke pritur barbarët”, vargu i fundit “Οἱ ἄνθρωποι αὐτοὶ ἦσαν μὴ κάποια λύσις” (*Ata ishin për ne njëfarë zgjidhjeje*) mungon te përkthimi i I. Kadaresë (83), ndoshta prej aludimeve politikisht të rrezikshme që mund të ushqente në kushtet e atëhershme të vetizolimit të Shqipërisë. Duhet përmendur këto fakte ndoshta edhe për të treguar se sa e fortë ka qenë frika e censurës, e cila çonte në autocensurë.

Vitet kaluan dhe pas 11 vjetësh, më 1997 K. Kavafi mbërriti përsëri në brigjet poetike shqiptare. Edhe këtë herë udhëtimi i K. Kavafit ndoqi itinerare të ndryshme. Në fillim erdhi drejtpërdrejt nga Aleksandria, por duke kaluar nga Greqia e sotme (përkthimi i L. Zykës), ndërsa pati edhe një rravim nga brigjet italiane (përkthimi i P. Jorgonit) dhe brigjet anglosaksone (përkthimi i R. Markut).

Atë vit u botuan dy libra. Viti 2001 shënon fundin e një rravimi tjetër të poezisë kavafiane në brigjet poetike shqiptare. Në të vërtetë, ky udhëtim kishte filluar rreth njëzet vjet më parë, përkatësisht aq sa zgjati edhe mungesa e Odiseut prej Itakës. Në një shënim hyrës të përkthyesit (Ll. Ruci) thuhet: “Poezinë e Kavafit e kam mbajtur nëpër duar përreth njëzet vjet me radhë, duke e përkthyer dhe ndrequr përkthimin në mënyrë të vazhdueshme dhe njëherësh, duke njohur sfondin historik të epokës që i referohen vjershat. Nëse ia kam arritur të jap tingëllimën e papërsëritshme të poezisë kavafiane në shqip, këtë le ta gjykojnë lexuesit, – por, sidoqoftë, ky Kavaf i plotë është i ndryshëm nga përkthimet e gjertanishme në shqip.” Kemi arsye t’i besojmë përkthyesit kur i referohet periudhës kohore gjatë së cilës u mor me përkthimin e Kavafit në shqip. Një argument na e jep edhe poezia “Qyteti”, me të cilën ai u përfaqësua në “Antologjinë e poezisë greke” (1986), plot 15 vjet para botimit të plotë të 154 poezive të Kavafit nga shtëpia botuese “Ombra”. Në të vërehen ndryshime të rëndësishme, saqë mund të bëjmë fjalë për dy përkthime nga i njëjti përkthyes. Ndërsa skrupuloziteti artistik dhe dëshira për të paraqitur diçka të re vërehet te Ll. Ruci edhe në detaje të tjera. I referohet botimit kryesor në gjuhën greke (atij të shtëpisë botuese “Ikaros”, kryer nën përkujdesjen letrare të Jorgos Savidhis-it) dhe e shfrytëzon atë deri në detaje, duke përkthyer edhe të dhënat biografike, parathënien, pasthënien, shënimet për çdo poezi, si dhe duke përfshirë edhe një shkrim të Linos Politis-it, njërit prej historianëve letrarë më në zë të Greqisë së sotme. Ll. Ruci respekton madje edhe strukturën e botimit të shtëpisë botuese “Ikaros”, duke e ndarë veprën e Kavafit formalisht në dy vëllime, pavarësisht se të dyja vëllimet e greqishtes te botimi shqip janë bashkuar në një vëllim të vetëm.

Ll. Ruci vjen me një përvojë përkthyesë të gjerë nga letërsia greke në shqipe. Përkundrazi, për L. Zykën botimi i K. Kavafit përbën sprovën debutuese përkthimore. Nga ana tjetër R. Marku, sidomos P. Jorgoni, vinin me një përvojë të konsiderueshme në fushën e përkthimit poetik. Është e vërtetë se ata të dy shfrytëzuan përkthime të K. Kavafit në gjuhë të tjera, përkatësisht në anglisht e italisht (kryer sipas gjuhëve

përkatëse nga Edmund Keeley e Philip Sherrard dhe Filippo Maria Pontani), fakt që pati ndikimin e vet në tekstet përfundimtare që u botuan. Megjithatë, gjykimi për përkthimin bëhet në bazë të tekstit të përfutur dhe jo *a priori*.

Në letërsinë botërore nuk janë të pakta rastet e ripërkthimeve e të ribotimeve që u kryhen kryeveprave të letërsisë botërore. Kjo nevojë lind për shkak të kërkesave që rrjedhin nga ndryshimet gjuhësore, nga ideali estetik, nga nevojat e publikut lexues. Vërehet në një kuptim njëfarë manipulimi i procesit përkthyes. Por botimi thuajse i njëkohshëm i disa përkthimeve të K. Kavafit mund të përbëjë një nga rastet e pakta në praktikën botuese dhe në fushën e letërsisë krahasuese. Le të shënojmë se në vitin 2010 dolën në dritë edhe dy përkthime të tjera të veprës së Kavafit: një i kryer nga M. Stefanllari dhe tjetri nga A. Spiro. Faktori kohor i imponimit të përkthimit në këtë rast nuk mund të merret parasysh. Çfarë është ajo, pra, që ka bërë të nevojshme të përkthehet e të ripërkthehet K. Kavafi në shqip? Mund të ishte nevoja dhe dëshira e një rishikimi, e një plotësimi, prej pamjaftueshmërisë absolute që nënkupton çdo përkthim, sado i mirë qoftë ai, aq më tepër kur fjala është për poezinë, shpallur teorikisht e papërkthyeshme. Ky argument mund të justifikohet, qoftë edhe pjesërisht, me përkthimin e Ll. Rucit. Por në rastin e përkthimeve të tjera, thuajse të njëkohshme? Mund të themi pa drojë më të vogël se koha e ndryshimeve të rëndësishme shoqërore të viteve ’90 të shekullit të kaluar krijoi jo vetëm trullin e përshtatshëm për mirëseardhjen e K. Kavafit në gjuhën shqipe, por gjithashtu kjo kohë kishte nevojë për poezinë e K. Kavafit. Poeti aleksandrin ndihmonte me mesazhet e veta universale njerëzore epokën e re të ndryshimeve.

Njëkohshmëria e ardhjes së K. Kavafit në shqip shtrihet në planin përkthimor disa probleme që lidhen me natyrën dhe cilësinë e përkthimit. Këto probleme, sigurisht, shihen të lidhura ngushtë edhe me aftësinë e përkthyesve, por së bashku me të edhe me strategjitë dhe taktikat e përkthimit, me marrëdhëniet ndërtekstore të origjinalit greqisht me kulturën shqiptare, si dhe me ballafaqime kulturash të tjera, në të cilat K. Kavafi kishte bujtur prej kohësh.

Te përkthimi i L. Zykës vërehet një përpjekje për të dhënë me besnikëri frymën e origjinalit. Shohim në të një orientim nga gjuha më shumë sesa nga kultura greke në përgjithësi. Konteksti që ka parasysh përkthyesi është ai gjuhësor dhe i lokalizuar tërësisht brenda faqeve të veprës kavafiane. Edhe parathënia, që do të ndihmonte për ta orientuar natyrshëm lexuesin shqiptar brenda një konteksti pragmatologjik, është e hartuar nga një përkthyes dhe studiues i Kavafit, por mosnjohës i gjuhës shqipe. Një argument tjetër të sigurt në mbështetje të mendimit tonë ofrojnë sidomos emrat e përveçëm. Siç dihet, në poezitë e K. Kavafit ndeshen rëndom emra dhe personazhe nga lashtësia greko-romake. Këta zakonisht në shqip shkruhen me trajtën e tyre të transliteruar, duke ndjekur domethënë shqiptimin e lashtë grek, dhe jo sipas shqiptimit të greqishtes së sotme. L. Zyka e shkruan gjithë këtë kategori emrash duke ndjekur modelin e greqishtes së re. Mund të justifikohet përpjekja e tij duke iu referuar K. Kavafit si autor i letërsisë së re greke, por tjetër gjë është mjeti i të shprehurit dhe tjetër gjë objekti i

shprehjes. Mund të hamendësojmë se L. Zyka ka shfrytëzuar edhe përkthimin anglisht të K. Kavafit. Si një fakt i jashtëm na shërben edhe përfshirja e parathënies së shkruar nga Edmund Keeley, një nga përkthyesit më të njohur të K. Kavafit në anglisht. Por edhe në përkthimin anglisht përkthyesit (Edmund Keeley dhe Philip Sherrard) kanë proceduar në mënyrë të pajustificueshme duke ndjekur modelin neogrek edhe për sa u përket emrave të lashtë. Kështu, krahas trajtave të pritshme si *Achilles* (5), *Apollo* (7), *Eleusis*, *Demeter*, *Thetis*, *Metaneira*, *Peleus* (13), *Euphorion* (105) ndeshim p.sh. edhe trajta të tilla të papritura, si *Evmenis* (10) (për *Eumenes*), *Theocritos* (10) (për *Theocritus*), *Dimitrios*, *Pyrrhos* (23) (në dëm të trajtave më të parapëlqyeshme *Demeter*, *Pyrrhus*), *Dionysos* (24) (në dëm të trajtës më të parapëlqyeshme *Dionysus*), *Herodis Atticos* (40) (për *Herodius/ Herodes Atticus*), *Evrion* (50) (për *Eurion*), *Theodotos* (54) (për *Theodotus*), *Orophernis* (60) (për *Orophernes*), *Selefkid* (61) (për *Seleukid*), *Ignatios* (79) (për *Ignatius*), *Aristovoulos* (89) (për *Aristobulus*), *Dimaratos* (114) (për *Demaratus*).

Përkthimin anglisht ka ndjekur hap pas hapi edhe R. Marku, i cili ka përsëritur besnikërisht të gjitha trajtat e dyshimta të emrave të përveçëm. Ashtu si në përkthimin anglisht, edhe këtu, krahas trajtave të sakta, si p.sh. *Hekuba* (30), *Demetra* (21), ndeshim trajta emrash, si *Evmenis* (18) (për *Eumen*), *Pileu* (21) (për *Peleu*), *Artemidoros* (42) (për *Artemidor*) etj.

Ndërsa P. Jorgoni, edhe pse ndihet që ka dijeni në lidhje me shkrimin, shqiptimin dhe emrat e greqishtes, merr si model përkthimin italisht të F. M. Pontanit, i cili mund të thuhet pa frikë se është një nga më të mirët që ekzistojnë për poezinë e K. Kavafit. Ai ka përkthyer me mjeshtëri disa poezi kavafiane. Le të përmendim p.sh. poezinë “Viti 31 para Krishtit në Aleksandri”, kur ruhet rima e çiftëzuar. Por gjejmë edhe raste kur nën ndikimin e tekstit italisht është përfutur në shqip një përkthim i gabuar. Një rast tipik është ai i poezisë “Gjon Kantakuzeni mbisundon”, e cila është përkthyer “Djaloshi Kantakuzinos eprori” (51), me sa duket nga moskuptimi i saktë i titullit në italisht (“Giovanni Cantacuzeno prevale”) (150), ku ‘Giovanni’ përkthehet me ‘djalosh’ (!). Në poezinë “Prej qelqi ngjyra-ngjyra” (që P. Jorgoni e jep “Xhama të ngjyrosura” khs. përkthimin italisht “Vetro colorato”) Gjon Kantakuzeni na del si Ivan (!) Kantakuzinos (55) dhe kisha e Vllahernës na del si Bllaqernes (55). Gjithashtu “Apolon tyanasi në Rod” na del si “Apoloni i Tianës në Rodi” (57), “Në një qytet të Azisë së Vogël” del si “Në një cep të Azisë së Vogël” (63), “Prifti i Serapit” del si “Prifti i Serapidës” (67) (khs. përkthimin italisht “Sacerdote di Serapide”, 171), “Ana Dalasena” del si “Ana Delasini” (68), “Kryezot prej Libisë Perëndimore” del si “Kryetar i Libisë Perëndimore” (80), “Le të kujdeseshin” del si “Po të

kishin menduar” etj. Nuk po zgjatemi me raste si këto, të cilat mund të gjenden me shumicë. Nuk është qëllimi ynë të shndërrohem në gjahtarë gabimesh. Gjithashtu, qëllimi ynë nuk është që të tregojmë se përdorimi i një përkthimi në një gjuhë të tretë do të sillte pasoja të dëmshme në përkthimin te gjuha marrëse. Këto përkthime jo vetëm që nuk pengojnë, por, përkundrazi, ndihmojnë veprën e vështirë të përkthyesit. Në rastin e K. Kavafit, stili gjuhësor i të cilit shënohet nga greqishtja e re, por edhe e folmja greke e Aleksandrisë dhe e Kostandinopojës, vështirësia në kuptimin e tekstit shumëfishohet. Në këto raste gjuha e tretë vjen në ndihmë në qoftë se përkthyesi e zotëron plotësisht, përndryshe ajo rrezikon të kthehet në një grackë. Nuk do ta tepronim po të thoshim se përkthimi nuk është thjesht një çështje gjuhësore. Nuk ka të bëjë vetëm me nivelin e kompetencës ndërgjuhësore, me dekodifikimin dhe rikodifikimin gjuhësor. Është, në radhë të parë, një kompetencë ndërkulturore, domethënë, njohja e saktë e kulturës ardhëse, njohja e saktë e kulturës pranuese, por edhe aftësia e vendosjes së një përkatësie të dykahshme midis shenjave kulturore që ofrojnë të dyja gjuhët. Këtu përfshihen edhe emrat e përveçëm të njerëzve dhe të vendeve, por edhe shprehje të ndryshme frazeologjike ose stereotipa fjalësh.

Një nga përkthimet më të mira të K. Kavafit në shqip është kryer prej Ll. Rucit. Vërehet në të puna e kujdesshme e një përkthyesi me përvojë, që mundohet të sjellë në gjuhën shqipe atë që provon lexuesi grek kur lexon Kavafin, të arrijë një njëvlershmëri formale (siç do të shprehej E. Nida), ose një përkthim semantik (P. Newmark). Përkthimi i tij është i orientuar nga origjinali. Respekton me skrupulozitet frazën e origjinalit, madje ndonjëherë deri edhe ndarjen e togfjalëshave midis fundit të një vargu dhe fillimit të vargut tjetër. Në këtë mënyrë i qëndron më besnik tekstit origjinal dhe, siç ndodh në këto raste, transparenca e përkthimit humbet (L. Venuti). Strukturat shqipe ngjajnë fort të ndikuara nga ligjërimi i K. Kavafit.

Ashtu siç mund të pritej, Ll. Ruci ka shfrytëzuar, krahas tekstit origjinal, edhe përkthime të K. Kavafit në ndonjë gjuhë tjetër, p.sh. në italisht. Kjo bëhet një shkas për të mos shmangur edhe rënien në ndonjë grackë. Një rast tipik na vjen përsëri nga emrat e vendeve. Në poezitë “Herodi i Atikës” (39) “Varri i gramatikanit Lisia” (43) dhe “Mes tavernave” (186) (personalisht do të parapëlqejë përkthimin “Nëpër mejhane”) gjendet edhe emri gjeografik Berito (*Aty pranë, djathtas kur hyn, në bibliotekën e Beritos varrosëm Lisian e ditur*) (Mes tavernave/ dhe shtëpive publike/ të Beritos zhgërryhem), i cili nuk është tjetër veç Bejrutit (kryeqyteti i Libanit) (khs. përkth. italisht: *Vicino adestra di chi entra, nella biblioteca/ di Bèrito, il dottissimo Lisia abbiamo sepolto*) (59) ose *In mezzo alle taverne/ e ai*

bordelli di Bèrito/ mi vado rotolando...) (163).

Këtu është vendi të themi dy fjalë në përgjithësi për përkthimet që vijnë nëpërmjet një gjuhe të tretë. Këto përkthime nuk janë të këshillueshme, pasi ndryshimet përfundimtare e largojnë tekstin fillestar origjinal nga teksti i përkthyer. Megjithatë, në raste të veçanta, kur janë të nevojshme, edhe mund të pranohen. Do të përfshiheshin këtu gjuhët e rralla, zotërimi i të cilave bëhet i vështirë, përderisa ato përfaqësojnë kultura me kontakt të largët ose shumë të largët. Gjithsesi, njohuritë kulturore janë të domosdoshme, për të mbyllur atë hendek që krijon mungesa e njohjes së gjuhës. Përkthimet letrare nga gjuha shqipe në atë greke dhe anasjelltas ofrojnë, për fat të keq, shembullin e një përvoje dekurajuese. Një pjesë e madhe e letërsisë shqiptare ka mbërritur në Greqi përmes një gjuhe të tretë, kryesisht nëpërmjet frëngjishtes (rasti i botimeve të I. Kadaresë do të mjaftonte për të ilustruar mendimin tonë). Por edhe shumë vepra të autorëve grekë kanë ardhur në shqipe nëpërmjet një gjuhe të tretë. Asgjë të keqe nuk do të kishte në rast se ndryshimet kuptimore që ndodhin gjatë përkthimit nga gjuha greke te gjuha e tretë nuk do të ishin kaq të largëta. Po të kemi parasysh elementet e përbashkëta gjuhësore midis shqipes dhe greqishtes, që i bën shënjesit kulturorë dhe mënyrën e jetesës së këtyre dy popujve lehtësisht të dallueshme dhe të kuptueshme me njëra-tjetrën, do të kuptojmë se sa shumë humb përkthimi që ndjek rrugën greqishte-italishte-shqipe, greqishte-anglishte-shqipe ose greqishte-frëngjishte-shqipe etj. Në vend të një përkthimi “transparent” (L. Venuti) lexuesi do të dëshironte një përkthim “dinamik” (E. Nida), i cili do të tingëllonte shqip, por do të jepte njëkohësisht edhe ato raporte kuptimore dhe efekte emocionale që krijohen nga leximi në origjinal. Shembuj të tillë mund të gjejmë shumë në vargje të veçanta në të tria përkthimet e K. Kavafit, por ende nuk gjejmë në shqip një Itakë përkthimi të K. Kavafit.

Le të krahasojmë një poezi të K. Kavafit në katër përkthime në shqip:

Është fjala për poezinë “Mbarim” (“*Τελειωμένα*”).

*Μέσα στὸν φόβο καὶ στὲς ὑποψίες,
μὲ παραγμένο νοῦ καὶ τρομαγμένα μάτια,
λνώνουμε καὶ σχεδιάζουμε τὸ πῶς νὰ κάμουμε
γιά ν’ ἀποφύγουμε τὸν βέβαιο
τὸν κίνδυνο ποὺ ἔτσι φρικτὰ μᾶς ἀπειλεῖ.
Κὶ ὅμως λανθάνουμε, δὲν εἶν’ αὐτὸς στὸν δρόμο·
ψεύτικα ἦσαν τὰ μηνύματα
(ἢ δὲν τ’ ἀκούσαμε, ἢ δὲν τὰ νοιώσαμε καλά).
Ἄλλη καταστροφή, ποὺ δὲν τὴν φανταζόμεθαν,
ἐξαφνικὴ, ραγδαία πέφτει ἐπάνω μας,
κὶ ἀνέτοιμους –ποῦ πιὰ καιρὸς– μᾶς συνεπαίρνει.*

Ja si është përkthyer:

Nga L. ZYKA:	Nga R. MARKU:	Nga Ll. RUCI:	Nga A. SPIRO:
FUNDI <i>Zhytur në frikë dhe në dyshime, mendjeprishur dhe sy të lemerisur, tretëmi në përpjekjet t’i shpëtojme rrezikut të sigurt që me tmerr na kërcënon. Por gabuam, të tillë rrezik nuk pamë; të rreme ishin lajmet (a ndoshta s’i dëgjuam, a mirë ne s’i kuptuam). Tjetër katastrofë, që kurrë nuk e menduam papritur pllakos mbi ne përnjëherë, s’ka më kohë të përgatitemi – dhe nën vete na merr.</i>	GJËRAT E PËRFUNDUARA <i>Të pushtuar frike dhe dyshimi mendjetrazuar me sytë e çakërdisur, me dëshpërim shpikim rrugëdalje bëjmë plane si të shmangim atë që nuk shmanget, rrezikun që na kërcënon me aq tmerr. E prapë gabojmë. S’ka rrezik para nesh: Informata që e rreme (a s’na e kapi veshi, a s’e kuptuam mirë). Një tjetër katastrofë, që kurrë s’e imagjinuam, Krejt papritur, dhunshëm, zbritet përmbi ne, Na gjen papregatitë, nuk kishim lënë as kohë, E na fshin faqes së dheut.</i>	PËRFUNDIMISHT <i>Mes frikës dhe dyshimeve, me mendje të shqetësuar dhe sy të lebetitur, zgjidhim dhe planifikojmë si të bëjmë të shmangim rrezikun e vërtetë që ashtu tmerrisht na kanoset. Por ama gabojmë, si s’është në rrugë (o nuk i dëgjuam, o nuk i ndjemë mirë). Tjetër katastrofë, që s’e merrnim me mend, e befte, e vetëtimtë bie mbi ne, dhe të papërgatitur – e ku ka kohë – na rrëmben.</i>	MBARIM <i>Mes frikës dhe dyshimeve, me mendje të dridhur dhe sytë plot llahtarë, tretëmi dhe vrasim mendjen ç’të bëjmë rrezikun e sigurt ta flakim tej, që ja kështu me tmerr na kërcënon. Por ne gabojmë, ai nuk gjendet udhës; kumtet ishin të rreme (o s’i dëgjuam dot, o mirë vesh s’i morëm). Një tjetër rrëmet që nuk e prisnim, papritmas papushim sipër na bie, dhe të papërgatitur – ku ka kohë tani – të gjithë na ka përfshirë.</i>

Me sa duket, udhëtimi i K. Kavafit ende nuk ka mbaruar. Dhe përvoja e fituar deri tani duhet të na bëjë edhe më të mençur, në mënyrë që ai të tingëllojë në shqip po aq i qartë sa në origjinal e në përkthimet më të mira në gjuhë të tjera të huaja. Dhe meqenëse çdo poezi e K. Kavafit përbën një sentencë jetësore,


do të ishte e papritur sikur të mos gjenin diçka që t’i referohej temës së këtij artikulli. Le të më lejohet t’i mbyll këto radhë duke cituar disa vargje nga një poezi e poetit aleksandrin, që ka lidhje me cilësinë e të shkruarit kur bëhet fjalë për ballafaqim kultu- rash:

*Greqishtja jote është përherë e bukur dhe melodioze.
Por tash ta duam gjithë mjeshtërinë.
Në gjuhë të huaj zia dhe malli na kalojnë.
Ndjenjën tënde egjiptiane derdhe në gjuhë të huaj.*

(Për Amonin, që vdiq më 610, në moshën 29-vjeçare)

EINSTEIN

Jeta dhe universi i tij



WALTER ISAACSON

Minerva